




Yeta Katolike

Botues: Kisha Katolike "Zoja e Shkodrës" New York

Viti LV Nr. 1-4, Janar-Dhjetor 2020, Çmimi \$5.00

*Ju urojmë
Krishtlindje të Shenjtë,
Krishtlindje gëzimi
e paqeje.*





Botues:

Kisha Katolike Zoja e Shkodrës

Drejtor:

Dom Pjetër A. Popaj

Kryeredaktor:

Mark K. Shkreli

Redaktor (anglisht):

Simon Vukel

Redaktor (shqip):

Klajd Kapinova

Graphic Design

Ismer Mjeku

Marketing

Fran Çotaj

Website:

Martin Smajlaj

Këshilli Botues:

Dom Pjetër A. Popaj

Mark K. Shkreli

Klajd Kapinova

Simon Vukel

Peter Saljanin

Ismer Mjeku

Martin Smajlaj

Fran Çotaj

Pashko Rr. Camaj

Gjon Chota

Luigj Çekaj

Tomë Paloka

Lekë Perleshi

Gjeto Turmalaj

Mhill Velaj.

Të gjitha shkrimet dhe artikujt i nënshtrohen redakturës.

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen edhe nëse nuk botohen.

Parapagimi: \$30 në vit

ADRESA E REDAKSISË:

361 W. Hartsdale Ave,
Hartsdale, New York 10530
Tel. (914) 761-3523
Fax (914) 949-2690
e-mail: ShkreliM@aol.com

P Ë R M B A J T J A

CONTENTS

Viti LV, Numri 1-4, Janar-Dhjetor 2020
Çmimi \$5.00 • www.jetakatlolike.com

Dom Pjetër Popaj: Besimi në Zotin gjatë Pandemisë3
 Papa Françesku lindja e Krishtit na jep forcë për të kapërcyer çdo provë4
 Pope reflects on past year: pandemic prompts acts of compassion5
 Ndërroi jetë Georg Ratzinger, vëllai i Papës së nderit6
 Letër e Papës në 1600-vjetorin e vdekjes së Shën Jeronimit7
 Papa Françesku emëroi Don Arjan Dodaj ipeshkëv-ndihmës të Tiranë Durrësit8
 Emërohet Nunci i ri Apostolik në Shqipëri8
By Andrea Tornielli: From a young migrant, educated as an atheist, to bishop in Albania9
By Msgr. Charles Pope: On the Fittingness And Faithfulness Of The Immaculate Conception ..10
By Dan Burke: The Spirit of Christ12
By Elizabeth Mitchell: She is Only Asleep13
Dr. Mons. Lush Gjergji: Shenjtëreshë për Dashuri14
By Clair Dwyer: A Special Power of Loving: Mother Teresa’s Letter on Women16
 5 tetor, 1980 Mesazhi i Shën Gjon Palit II drejtuar popullit shqiptar18
 Më 18 tetor 1685 botohej “Çeta e profetëve” e imzot Pjetër Bogdanit19
 Më 20 mars 1592 papas Lukë Matrënga përfundoi ‘Doktrinën e krishterë’20
Nikolin Sh. Lëmezhi: Tashmë jam si engjëjt e humbur...21
Klajd Kapinova: Arrestimi, pushkatimi dhe lumnimi i Abati të fundit të Mirditës imzot Frano Gjinit
 Demografitë25



Krishtlindje 2020, Kisha Katolike Zoja e Shkodrës.

Gjatë vitit 2020 dhe tani në vitin 2021 krejtë bota është prekur prej COVID-19 në një mënyrë apo një tjetër. Edhe ne kemi pasur më shumë vdekje se ndonjëherë në famullinë tonë, të gjitha nuk kanë qenë prej virusit, shumë kanë vdekur prej smundjeve tjera apo moshes së epërme. Prej tyre kemi pasur shumë të rinj që kanë vdekur parakohe. Pa marrur para syshë moshën e smundja, vdekja është gjithmonë fatkeqësi e tragjedi. Ata qofshin mirë në atë jete e qëzofshin lumturinë e Parrizit. Familjeve



Dom Pjetër Popaj

të piklluara Zoti u dhëntë forcë e qëndrueshmeri. Kemi shumë që janë ende të infektuar ndër shtëpija edhe nëpër spitale. E lusim Zotin që t'ua kthejë shëndetin e ta kapërcejnë sa më parë.

Të gjithë akoma jemi të habitur se si kjo pandemi ka mundur të ndodhte në botë. Mijëra kanë vdekur, miliona kanë humbur punën, miliona të infektuar e shumë të tjerë të frikësuar se do të infektohen. Numri i grindjeve nëpër shtëpija rritet më tepër. Sigurimi publik, nëpër rrugë e sheshe është shumë i dobët. Pse Zoti e lejon një gjë të tillë? Si përgjigjen besimtarët? Kemi disa reflektime që na ndihmojnë të thellohem më tepër nga ana shpirtore në këtë periudhë të pandemisë.

Ndoshta Zoti e lejon këtë të keqe për të na zgjuar prej gjumit. Vetëm kur jemi me shpinë për murë, në mbarim të rrugës, pa dritë e në terr, kur nuk mundemi me ikë prej rrezikut edhe kur Zoti duket larg, atëherë e kuptojmë se vetëm Zoti mund ta ndalojë. Në këtë situatë Zoti është edhe më afër nesh. Kur qielli është i errët gjatë natës hyjet shëndrisin më shumë thotë një proverbë e vjetër. Zoti don që ne të afrohem

Besimi në Zotin gjatë P A N D E M I S Ë

më shumë Atij dhe njëri tjetrit. Krishti i Lum na siguron se nuk jemi vetëm, Ai është me ne gjithëherë. Sikurse na ka shërbyer duke dhënë jetën për ne ashtu lypë që edhe ne të shërbejmë të tjerët. Ai na mëson se jeta ka kuptim vetëm në shërbim Zotit e të afërmit.

Kjo tragjedi e COVID-19 na kujton për t'u përqendruar në gjërat serioze, gjërat që na bashkojnë. Kjo është një luftë kundra të keqit, jemi të gjithë në vuajtje. Sikur ushtarët në luftë, edhe ne duhet të mbrojmë dhe të ndihmojmë njëri tjetrin. Thelbi i shërbimit është dashuria e thadrruar në lutje e në dhëmshuri për të tjerët, duke falur gabimet e tyre si në familje ashtu në shoqëri.

Në situatë të vështira Zoti gjithmonë na ndihmon dhe na jep shpresë. Në qoftë se nuk bazohemi krejtësisht në Të, më shumë kemi për ta ndie kërcënimin e virusit që shkakton ankth dhe dëmton ndjenjat dhe mendjen. Kur jemi me Zotin gjejmë optimizëm edhe në kohë tragjike. Viktor Frankl, psikiatër nga Vienna,

mbijetimin e tij të Holokaustit e përshkruan si një fitore. Ai thotë se kur jemi të piklluar, të smurë, të frikësuar, apo në dhimbje e në mundime, duhet pasur besim. Duhet që gjërat negative në jetë t'i kthejmë në gjëra positive e konstruktive.

Zakonisht kur ne kqyrim për kuptimin e jetës tregon se nuk jemi në paqe me vetën tonë. Kemi vurë re se gjatë pandemisë njerëzit kanë treguar më tepër ndjeshmëri ndaj nevojtarëve. Kemi pasur "help groups" për blerje dhe shërbime ushqimesh për të smurit e pleqë të kufizuar ndër shtëpia. Shumë kompani me biznese të vogëla kanë ofruar shërbimet falas. Shihet një afërsi më e madhe me kujdestarët nëpër shtëpia, me mësuesat, me infermierët e mjekë. Kjo periudhë e keqe nuk do të mbahet në mend si një kohë e gëzueshme por si një kohë afërsie e njerzie për nevojtarët tanë.

Udhëzime të vogla për ne. S'parit të falënderojmë Zotin për çdo ditë, si një dhuratë prej Tij. Çdo mirësi që e kemi në jetë e kemi prej Tij. Kur lute-

mi, ta ndiejmë parrinë e Tij. E dijmë se Ai na veshtron dhe përgjigjet lutjeve tona ndoshta jo krejt ashtu si mendojmë ne. Kur lutemi për të tjerët, i kujtojmë sikur të ishim në të njëjtin vend me ne, atëherë ia paraqesim Zotit që të kujdesohet për ta.

Mos të frikësohemi por me fe të gjallë të besojmë në Zotin. Feja fillon kur e dijmë se kemi nevojë për t'u shëlbuar. Sikur apostujt e frikësuar në barkë, duke u mbytur prej tallazave, ashtu edhe ne të thërrasim Krishtin në barkat tona të mbuluara me tallaze vuetjesh e rreziqesh që të na shpëtojë. T'ia dorzojmë frikat tona Atij që i shëndron në siguri e paqe.

Nepër Kryqin e Krishtit jemi shëlbuar, sheruar dhe mbajtur mbi supat e Tij ndërsa i varur në kryq. Duke i përngjar Atij ta marrim kryqin tonë, të gjejmë kurajo në këtë pandemi, duke lën pas padurimet e mos kënaqësitë tona. Ti bëjmë vend Shpirtit Shenjt që të na forcojë në dashuri, qëndrueshmëri dhe në shërbim të njëri tjetrit.





Papa Françesku lindja e Krishtit na jep forcë për të kapërcyer çdo provë

Në Meshën tradicionale të Natës së Krishtlindjes, Papa Françesku na kujton se “Zoti nuk mund të mos na dojë”, Hyji na njohu si bijtë e Tij të dashur, e kjo është pikënisja e çdo rilindjeje; “zemra e pathyeshme e shpresës sonë” është më e fortë se frika për të ardhmen. Në përfundim të homelisë kujton vargjet simbolike të poeteshës së famshme amerikane Emily Dickinson: “Që sonte streha e Zotit është pranë strehës sime. Orenditë janë dashuria”.

Mesha e Krishtlindjes, që në përshtetërinë popullore vijon të quhet “Mesha e Mesnatës”, sivjet edhe në bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, për shkak të koronavirusit, u kremtua nga Papa shumë më heret se në çdo vit tjetër: nisi në orën 7:30 të mëngjes, jo në orarin e zakonshëm, pra, por me fe e devocionin e zakonshëm, edhe në këtë vit të jashtëzakonshëm.

“Lindja e Jezusit është risi që na lejon çdo vit të rilindemi në brendësi, për të gjetur tek Ai forcën për t’u përballur me çdo provë. Po, sepse lindja e Tij është për ne: për mua, për ty, për secilin dhe çdonjërin.

Ai ka lindur për mua, Ai ka lindur për ne”, tha Papa Françesku në homelinë e Meshës së Natës së Krishtlindjes”.

Sonte për ne lindi Shëlbuesi!

Natë profetike e sontmja!” Në këtë Natë të Shenjtë përmbushet profecia e Izaisë: “Na lindi një fëmijë, na u dhurua një djalë!”.

“Na lindi një djalë” - me këtë kumt gazmor e nisi Papa homelinë e Meshës, kremtuar Natën e Krishtlindjes, në orën 19.30, në Bazilikën e Shën Pjetrit. E menjëherë shpjegoi ç’do të thotë ky kumt i madh ‘për gjithë njerëzimin’. Do të thotë se Biri i Zotit, i bekuari për natyrë, vjen të na bëjë të bekuar edhe ne, përmes hirit. Vjen të na bëjë bij të Zotit. Kjo, dhurata e kësaj nate. Dhuratë e mahnitshme. Sonte Zoti na mrekullon e i thotë secilit nga ne: “Ti je mrekulli. Vëlla, motër, mos u trishito!... Zoti të thotë je im bir!”. E kjo është zemra e pashkatërrueshme e shpresës sonë!

Zoti na do më shumë se e duam vetveten

Na u dhurua një Djalë! Ati nuk na dhuroi ndonjë gjë, por Birin e tij të vetëm, gëzimin e tij të plotë. Tepër e madhe kjo dhuratë për ne. A e meritojmë? - pyeti Papa në vijim të homelisë - Thua bëri mirë

Zoti, që na dhuroi kaq shumë? Thua bën mirë, që vijon të na besojë? Që na mbivlerëson?

“Po, na mbivlerëson, sepse na do për vdekje. Nuk mund të mos na dojë, Kështu është bërë! Krejt ndryshe nga ne. Na do më shumë se e duam vetveten. E ky është sekreti, për të na hyrë në zemër”.

Dashuria e Zotit, mënyra e vetme për të shpëtuar

Nado, mbasi e di se dashuria është mënyra e vetme për të shpëtuar, për ta shëruar shpirtin. E di se ne ndreqemi vetëm duke e pranuar dashurinë e tij të palodhshme, që nuk ndryshon, por na ndryshon:

“Vetëm dashuria e Jezusit e shndërron jetën, i shëron plagët më të thella, na çliron nga pakënaqësia, nga zemërimi, nga ankimet e pafund”.

Na u dhurua një djalë! Një djalë, që erdhi natën, pa strehë, i varfër, i papërbujtur, ndërsa meritonte të lindej në pallatin më të madh, më të bukur! Pse? - pyeti Papa: “Për të na bërë të kuptojmë deri në ç’masë e do njeriun. Biri i Zotit lindi i braktisur nga shoqëria, për të na treguar se çdo i baktisur është biri i Zotit. Zoti e vuri gjithë shëlbimin tonë mbi grazhdin e një stalle, pa u trembur nga varfëritë njerëzore: ta lëmë që mëshira tij t’i shndërrojë mjerimet tona”.

Zoti lindi në grazhd, për të na e orientuar jetën

Në vijim të homelisë së Meshës të kësaj Nate të jashtëzakonshme Krishtlindjeje, në Bazilikën e Vatikanit, në praninë e një grushti njerëzish, më pak se kurrë, për shkak të situatës së vështirë që jeton mbarë bota - Papa i mori përdore besimtarët e i çoi në atë kohë të largët, që sot e quajmë “Dita e parë e vitit të parë pas Krishtit”. Pas Zotit që - kujtoi Ati i Shenjtë - lindi në grazhd, për të na e orientuar jetën. Lindi në Betlehem, që do të thotë “Shtëpia e bukës”, si të donte të na kujtonte se kemi nevojë për të, si për bukën e përditshme:

“Sa herë ne - vijoi të kujtojë Papa Françesku - të writur për dëfrime, për sukseste e kënaqësi, e ushqejmë jetën me gjelë, që nuk ta shuajnë urinë e të lënë në shpirt një boshllëk të frikshëm”.

Zoti, me gojën e Izaisë, ankohej se, ndërsa

kau e gomari e njohin grazhdin e tyre, ne, populli i tij, nuk e njohim Atë, që është gurra e jetës sonë. Nuk e njohim e kërkojmë ethshëm grazhde kotësish, duke e harruar grazhdin e Betlehemit, ku lindi ai, që nuk flet, por na fal jetën. Ndërsa ne jemi analfabetë në mirësi. Dashuria e tij e çarmatosur e çarmatosëse na kujton se kohën që kemi nuk duhet ta kalojmë duke qarë, por duke fshirë lotët e atyre që vuan. Zoti vjen të banojë ndër ne i varfër e nevojtar; vjen për të na kujtuar se e duam,

duke u shërbyer të varfërve. “Që sonte - siç shkruante poetesha e famshme amerikane Emily Dickinson - streha e Zoti është nën strehën time. Orenditë janë dashuria” (*E. Dickinson, Poems, XVII*).

Jezusi Biri, që më bën bir

Na u dhurua një djalë! Je Ti, Jezus, Biri, që më bën bir – theksoi Papa në përfundim të homelisë - Ti më do kështu si

jam, jo si e ëndëroj vetveten. Duke të përqaftuar Ty, Ferishte e grazhdit, përqafto rishtas jetën time! Ti që më shpëton, mëson më të shërbej. Ti që nuk më lë kurrë vetëm, ndihmomë t’i ngushëlloj vëllezërit e tu, sepse sonte të gjithë janë vëllezërit e mi!

“Ju uroj Krishtlindje të shenjtë. Krishtlindje gëzimi e paqeje”.

RV

Pope reflects on past year: pandemic prompts acts of compassion

In the homily prepared for New Year’s eve Vespers, Pope Francis asks how we can give thanks to God after such a difficult year. God, he says, always has compassion for us, and we are thankful for the acts of closeness, care, and solidarity that we have seen throughout 2020.

Pope Francis, suffering from an attack of sciatica, was absent from the celebration of Vespers and the recitation of the *Te Deum* – the Church’s solemn chant of Thanksgiving for the past year – but nonetheless offered a reflection on how we can give thanks for the year that is drawing to a close.

The liturgy was presided over by the Dean of the College of Cardinals, Cardinal Giovanni Battista Re, who pronounced the homily prepared by Pope Francis for the occasion.

In his homily, Pope Francis wrote that giving thanks “at the end of a year like this” might seem “forced,” or even jarring, especially when we think of families who have lost loved ones, of the sick, of those who have suffered alone, or who have lost their jobs.

“What sense does a tragedy as this have,” he asked. In the face of our questions, he responded, God does not appeal to “higher reasons,” as if He would sacrifice individuals for some higher good. Instead, His response is the Incarnation, sending His Only Son to become man to save each and every one.

Like the good Samaritan, God is moved with compassion, helping those who are suffering. And in this attitude, the Pope said, we can perhaps “find the ‘meaning’ meaning of this tragedy, of this pandemic, as well as other scourges that afflict humanity: that of arousing compassion in us and provoking attitudes and gestures of closeness, care, of solidarity, of affection.”

We see this happening around the world, and even in Rome, Pope Francis wrote, and “it is above all for this that we give thanks to God this evening: for the good things that have taken place in our cities during the lockdown and, in general, throughout the pandemic, which unfortunately is not yet over.”

Pope Francis praised the “many people who, without making noise, have tried to



make the weight of the trial more bearable.” He singled out not only healthcare workers, and priests and religious on the front lines, but also “all those who strive every day in the best way possible to carry on their service to their families and to those who are committed in their service to the common good.” He singled out especially teachers and school administrators, as well as civic leaders who put the good of others, especially the most disadvantaged, ahead of their own private interests.

“All this cannot happen without the grace, without the mercy of God,” Pope Francis said. “How is it possible... that so many people, without any other reward than of doing good,

found the strength to be concerned about others?” he asked. “In the end, even if they themselves are not aware of it, what fortifies them is God’s strength which is more powerful than our selfishness.” And so, the Pope said, “For this reason, this evening we give praise to Him, because we believe and we know that all the good that is accomplished day after day on earth, in the end, comes from Him, comes from God.”

The Pope concluded his prepared remarks by looking toward the future that awaits us, with the prayer, “May your mercy always be with us, Lord, for we have hoped in You.”

Vatican News

Ndërroi jetë Georg Ratzinger, vëllai i Papës së nderit

Prelati i moshuar bavarez ndodhej në Regensburg, qytet ku jetoi e ku, pak ditë më parë, u takua me vëllain. Ishin shuguruar meshtarë së bashku.

Georg Ratzinger, vëllai i madh i Papës së nderit, mbylli sytë në moshën 96 vjeçare. Lëngonte në Regensburg, qytet ku kaloi pjesën më të madhe të jetës. Me vdekjen e tij, Joseph Ratzinger, që më 18 qershorin e kaluar përballoi udhëtimin e vështirë në avion për ta parë edhe një herë vëllain në orët e fundme, humbet anëtarin e vetëm të familjes, ende gjallë. Të shuguruar meshtarë në të njëjtën ditë, njëri muzikant e mjeshtër i një kori të famshëm, me emrin tingëllues “Kori i Harabelave”, sepse i përbërë nga zëra të bardhë femijësh të mitur - tjetri, teolog, ipeshkëv, kardinal e Papë - qenë gjithnjë shumë të bashkuar.

Meshtar e muzikant i lindur

I lindur në Pleiskirchen të Bavarisë, më 15 janar 1924, Georg Ratzinger kishte nisur t'i binte organos në kishën famullitare që kur ishte 11 vjeç. Në vitin 1935 hyri në seminarin e vogël të Traunstein, por më 1942 u rekrutua në Reichsarbeitsdienst e më pas edhe në Wehrmacht, në Forcat e Armatosura Gjermane, të cilat luftuan edhe në Itali. Më 1947, së bashku me vëllain Joseph, hyri në seminarin e Herzogliches Georgianum, në Munihi të Bavarisë. Më 29 qershor 1951 të dy vëllezërit u shuguruan meshtarë në Katedralen e Freising-ës, nga kardinali von Faulhaber. Pasi u emërua mjeshtër i Kapelës në Traunstein, për 30 vjet me radhë, nga viti 1964, deri më 1994, që drejtor i korit të Katedrales së Regensburgut, kori i famshëm “Regensburger Domspatzen”. Shëtitu në vende të ndryshme të botës, duke dhënë një mori koncertesh dhe drejtoi shumë regjistrime radiofonike në Deutsche Grammophon, Ars Musici e në qendra të tjera diskografike, me prodhime kushtuar Bach, Mozart, Mendelssohn e autorë të tjerë me famë botërore.

Dy vëllezër të lidhur ngushtësisht

Dy vëllezërit ishin të lidhur ngushtësisht aq, sa Benedikti XVI shkruan:

“Që në fillim të jetës sime, im vëlla ishte për mua jo vetëm shok, por edhe prijës i besueshëm. Për mua ishte pikë orientimi e mbështetjeje me qartësinë e me vendosmërinë në marrjen e vendimeve. Më tregoi gjithnjë rrugën, në të cilën duhet të ecja,



Georg Ratzinger dhe Papa i nderit Benedikti i XVI

edhe në situata tejet e të vështira”.

“Im vëlla e unë - pati thënë Georg Ratzinger 11 vjet më parë gjatë një interviste - ishim të dy ministrantë, ndihmonim të dy në meshë. Shumë shpejt e patëm të qartë se jeta jonë do të vihej në shërbim të Kishës”.

E, më pas, pati kujtuar fëmijërinë:

“Në Tuttnoning Joseph mori krezmimin nga kardinali Michael Faulhaber, kryepeshkovi i madh i Munihut, që i pati lënë mbresa të mëdha, aq sa pati pohuar se do të dëshironite të bëhej edhe ai vetë kardinal. Por vetëm pak ditë më pas, duke vërejtur bojaxhiun, që lyente muret e shtëpisë sonë, pohoi se kishte ndërruar mendim e se do të bëhej bojaxhi”.

Të lidhur ngushtësisht edhe nga muzika

George pati folur edhe për muzikën, që i lidhte ngushtësisht:

“Në shtëpinë tonë të gjithë e donin muzikën. Babai kishte një çeste e i binte shpesh në orët e mbrëmjes. Këndonim të gjithë së bashku. Për ne kjo ishte ngjarje e madhe. Në Marktl mbi Im, pastaj, ishte një bandë muzikore, që më joshte shumë. Mendoja se muzika është një nga gjërat

më të bukura, që ka krijuar Zoti. Edhe im vëlla e ka dashur gjithnjë shumë muzikën”.

Pas vendimit të kardinajve, ishte Dora e Zotit

George Ratzinger, njeri i sinqertë, me sjellje pak diplomatike, nuk e fshehu kurrë se nuk u gëzua aq shumë, kur e mori vesh se i vëllai që zgjedhur Papë, në prill 2005: *“Duhet ta pranohet se nuk e prisja - pati thënë - e mbeta paksa i zhgënjyer... Duke pasur parasysht impenjimet e shumta, kuptova se marrëdhëniet tona nuk do të ishin më aq të shpeshta. Sidoqoftë, pas vendimit njerëzor që morën kardinajtë, ishte Dora e Zotit, e kësaj Dore duhet t'i themi gjithnjë po!”.*

Më 2011, i intervistuar nga një revistë gjermane, Georg Ratzinger pati thënë: *“Nëse nuk do të ketë mundësi ta kryejë deyrën në këndvështrimin fizik, im vëlla duhet të marrë guximin të japë dorëheqjen”.*

E ishte beqerisht ai që e mori i pari lajmin e dorëheqjes së vëllait nga papnia: *“Moshë e bën të vetën - pati thënë - im Vëlla dëshiron pakëz qetësi në pleqëri”.*

Por ai vetë, pa marrë parasysht ligështinë e këmbëve e të syve, shtegtoi disa herë drejt Romës, ku kaloi shumë kohë në Manastirin Mater Ecclesia, në shoqëri me Benediktin, sot në zi për këtë humbje të madhe!




Letër e Papës në 1600-vjetorin e vdekjes së Shën Jeronimit

I kushtohet dashurisë së Shën Jeronimit për Shkrimin Shenjt, Letra Apostolike "Scripturae Sacrae Affectus" e Papës Françesku, botuar pikërisht në ditën kur të krishterët përkujtojnë Atin e madh të Kishës, në 1600-vjetorin e vdekjes. Papa i fton të gjithë të përfitojnë nga trashëgimia e atij, të cilit i detyrohemi për përkthimin e Biblës në latinisht. Të rinjve, thirrja: shkoni në kërkim të gjithçkaje na ka lënë Shën Jeronimi.

"Figura e e tij mbetet me aktualitet të madh për ne të krishterët e shekullit XXI", prandaj, pikërisht për këtë, 1600 vite pas vdekjes, Papa Françesku i kushton Shën Jeronimit, njërit prej Etërve më të mëdhenj të Kishës, Letrën Apostolike "Scripturae Sacrae Affectus", që u botua sot. Pikërisht "affectus", dashuria për Shkrimin Shenjt është trashëgimia, që Shën Jeronimi i "la Kishës me jetën dhe veprat e tij". "Studiues i palodhur, përkthyes, ekzegjet, njohës i thellë dhe divulgator i apasionuar i Shkrimit Shenjt", "interpretues i hollë i teksteve biblike", "mbrojtës i flaktë dhe nganjëherë plot vull i së vërtetës së krishterë", eremit asketik dhe tejet kërkues, përveçse udhërrëfyes ekspert shpirtëror: ky ishte Shën Jeronimi.

Dy çelësat për ta kuptuar Shën Jeronimin

Pa hyrë në jetën e shenjtit të madh, për të cilën ju ftojmë të lexoni Letrën e plotë, ku Papa përshkruan gjerë e gjatë edhe lidhjet e tij me Romën, nga Betlehemi ku jetonte e punonte, vëmë në dukje dy karakteristika të përkthyesit të Biblës në gjuhën latine (Vulgata), që Ati i Shenjtë i përvijon kështu: "Për ta kuptuar plotësisht personalitetin e Shën Jeronimit - thekson Françesku – duhen kombinuar dy përmasa tipike të jetës së tij si besimtar: nga njëra anë, përkushtimi absolut dhe rigoroz ndaj Zotit, duke hequr dorë nga çdo kënaqësi njerëzore, për dashurinë e Krishtit në kryq (shih 1 Kor 2,2; Fil 3,8-10); nga ana tjetër, impenjimi me zell të jashtëzakonshëm në studime me të vetmin qëllim për ta kuptuar gjithnjë e më mirë misterin e Zotit". Këto dy karakteristika, që theksohen edhe në artin, me të cilin paraqitet ky Atë i Kishës, e bëjnë atë model "për murgjërit, para së gjithash, që ata, të cilët jetojnë në asketizëm e lutje të inkurajohen t'i përkushtohen punës së zellshme të kërkimit dhe të mendimit; e pastaj, për studiuesit, të cilët duhet të kujtojnë se dija është e vlefshme nga pikpamja fetare, vetëm nëse bazohet në dashurinë ekskluzive për Zotin, në zhveshjen nga çdo ambicie njerëzore dhe nga çdo aspiratë e kësaj bote".



Dashuria për Shkrimin Shenjt

"Tipari i veçantë i figurës shpirtërore të Shën Jeronimit - vëren më tej Papa Françesku - mbetet pa dyshim dashuria e tij e apasionuar për Fjalën e Zotit". Nga Shkrimi Shenjt, Shën Jeronimi nënvizon "karakterin e përvuajtur të zbulesës së Zotit, që shprehet përmes natyrës së ashpër e gati primitive të gjuhës hebraike, nëse e krahasojmë me përkryerjen e latinishtes ciceroniane", dhe na mëson se "nuk duhen studiuar vetëm Ungjijtë e nuk duhet komentuar vetëm tradita apostolike, e pranishme në Veprat e Apostujve e në Letrat e ndryshme, sepse e gjithë Besëlidhja e Vjetër është e domosdoshme për të depërtuar në të vërtetën dhe në trashëgiminë e Krishtit". "Shën Jeronimi – shkruan Papa – është udhërrëfyesi ynë, sepse... e çon çdo lexues drejt misterit të Krishtit, për faktin se merr përsipër me përgjegjësi e sistematikisht ndërmjetësimin kishtar e kulturor të nevojshëm për leximin e drejtë e të frytshëm të Shkrimit Shenjt". Ati i Shenjtë kujton më pas kompetencat e tij gjuhësore, analizën e saktë dhe vlerësimin e dorëshkrimeve, punën kërkimore arkeologjike, si edhe njohuritë e kohës mbi historinë e interpretimit e të metodologjisë së studimit të Shkrimit Shenjt, që Shën Jeronimi i përdori dhe i vuri në jetë me mjeshtëri të rrallë. Përkthimi i tij, sipas Papës, është "inkulturim" i Biblës në gjuhën e në kulturën latine.

Sfida e Papës Françesku për të rinjtë

Së fundi, Papa vë në dukje se "një nga problemet e sotme, jo vetëm të fesë, është analfabetizmi: janë të paktë njerëzit me aftësi hermeneutike, që i bëjnë ata interpretues dhe përkthyes të besueshëm të traditës sonë kulturore". Prej këtej, ftesa: "Kam një sfidë, sidomos për të rinjtë – shkruan Ati i Shenjtë - shkoni në kërkim të trashëgimisë tuaj. Krishterimi ju bën trashëgimtarë të një pasurie kulturore të paimagjinueshme, të cilën duhet ta bëni tuajën. Apasionohuni pas kësaj historie, është e juaja. Me guxim nguleni vështrimin tek ai i ri i shqetë, tek Jeronimi, i cili, si protagonist i shëmbëlltyrës së Jezusit, shiti gjithçka kishte për të blerë 'margaritarin me vlerë më të madhe'. "Shën Jeronimi është 'Biblioteka e Krishtit' - vëren Papa - një bibliotekë e përherëshme, që gjashtëmbëdhjetë shekuj më vonë, vazhdon të na mësojë ç'është dashuria për Krishtin, një dashuri e pandashme nga takimi me Fjalën e Tij. Prandaj, 1600-vjetori i tanishëm përfaqëson një thirrje për të dashur atë, që donte Shën Jeronimi, duke rizbuluar shkrimet e tij dhe duke e lënë veten të preke-mi nga një përshtirë, që mund të përshtirë, në thelbin e saj më jetësor, si dëshirë e shqetë dhe e apasionuar për njohjen më të thellë të Zotit të Zbulesës". Dhe me fjalët e vetë Shën Jeronimit, Papa Françesku këshillon: "Lexojeni shpesh Shkrimin Shenjt; madje, mos e lëshoni kurrë nga dora librin e shenjtë".

R.SH. - Vatikan

Papa Françesku emëroi Don Arjan Dodaj ipeshkëv-ndihmës të Tiranë Durrësit

**Kryedioqeza e Tiranë-Durrësit ka një ipeshkëv të ri ndihmës:
Imzot Arian Dodajn, aktualisht Mëkëmbës i përgjithshëm i Tiranë-Durrësit.**

Kryedioqeza e Tiranë-Durrësit ka një ipeshkëv të ri ndihmës: Imzot Arian Dodajn. Meshtari i mirënjohur, don Arjan Dodaj,



Don Arjan Dodaj

lindi në Laç të Kurbinit, në Kryedioqezën e Tiranë-Durrësit, më 21 janar 1977. Në vitin 1993, pasi kishte kryer shkollën e mesme në qytetin e lindjes, emigroi në Itali. U vendos në Cuneo, ku nisi të punojë.

Më 1977 kërkoi të pranohej në Vëllazërinë Meshtarake të Bijve të Kryqit, pranë Bashkësisë "Shtëpia e Marisë", në Romë. Në rrugën e përgatitjes për meshtari, nisi studimet e filozofisë e të teologjisë pranë Universitetit Papnor "Mbretëresha e Apostujve" ku mori titullin e Bakalaureatit.

U shugurua meshtar më 11 maj 2003 nga Papa Gjon Pali II, në Bazilikën e Shën Pjetrit dhe u inkardinua në Dioqezën e Romës, si anëtar i Vëllazërisë meshtarake të Bijve të Kryqit, në bashkësinë " Shtëpia e Marisë".

Pas shugurimit meshtarak kreu detyra të ndryshme baritore. Nga 2003 deri më 2004

ishte zëvendës-famullitar në Famullinë "Shën Domenico Guzman", në Romë; nga 2004 deri më 2005, Zëvendës-Rektor i Rektorisë së "San Giovanni della Malva" dhe Kapelan i bashkësisë shqiptare në Romë; nga 2005 deri më 2017, zëvendës famullitar i Famullisë "Shën Rafaeli Kryeengjell", në Romë.

Më 2027, me miratimin e ipeshkëvit të vet, Kardinalit-Mëkëmbës të Shenjtërisë së Tij për Dioqezin e Romës, u transferua si meshtar fidei donum në Kryedioqezën e Tiranë-Durrësit, ku kreu këto detyra baritore: Mëkëmbës i përgjithshëm, Famullitar i famullisë të "Zemrës së Papërlyer të Zojës Mbretëreshë" në Gramëz; Drejtues i baritorisë universitare; Sekretar i dytë i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare dhe sekretar i përgjithshëm i Sinodit dioqezan.

Ipeshkëvit të ri i urojmë punë të mbarë nën hijen e Kryqit të Jezu Krishtit - e pranë Zemrës së Zojës!

Emërohet Nunci i ri Apostolik në Shqipëri

Ati i Shenjtë Françesku emëroi Nuncin e ri Apostolik në Shqipëri. Është Shkëlqesia e Tij, imzot Luigi Bonazzi, kryeipeshkëv titullar i Atella-s, deri tani Nunc Apostolik në Kanada.

Imzot Bonazzi lindi në Gandino, më 19 qershor 1948. U shugurua meshtar më 30 qershor 1973, pasi kishte kryer studimet teologjike e ishte lauruar në psikologji dhe në shkencat e edukimit. Më 1977 vijoi studimet në Akademinë Papnore Kishtarë, ku formohen diplomatët e Selisë së Shenjtë.

Në përfundim të studimeve, shërbeu në Nunciaturën apostolike të Kamerunit(1980-83), në Trinidad (1983-86) e në Maltë (1986-89). Më pas u emërua pranë nunciaturës apostolike në Spanjë (1991-94), këshilltar



Imzot Luigi Bonazzi

pranë asaj të SHBA-ve (1994-96), më pas në Itali (1996-99) e në Kanada.

Më 19 qershor 1999 u emërua

kryeipeshkëv titullar i Atella-s e nunc apostolik në Haiti, duke e marrë shugurimin ipeshkvnor në Katedralen e Bergamos, më 26 gusht, gjatë një bashkëkremtimi eukaristik, kryesuar nga kardinali Angelo Sodano, asokohe Sekretar i Shtetit të Vatikanit. Më 30 mars 2004 u emërua nunc apostolik në Kubë.

Më 14 mars 2009 Papa Benedikti XVI e emëroi Nunc në Lituani e Estoni e më 18 dhjetor 2013, Papa Françesku e ngarkoi me detyrën e nuncit në Kanada.

Tani imzot Luigi Bonazzi është nunci i ri apostolik në Shqipëri, ku do të vijojë shërbimin diplomatik që nisi menjëherë pas shembejs së komunizmit, me nuncin e parë apostolik, kardinalin e ndjerë Ivan Dias. RV

From a young migrant, educated as an atheist, to bishop in Albania

He arrived in Italy by boat in 1993, became a welder, discovered the faith that his grandmother had transmitted to him by singing, and became a priest.

Three years ago, he returned to Albania.

By **Andrea Torielli**

I could still detect in his voice, on the phone from Tiranë, the surprise of what has just happened to him. It's not long since he received the announcement of the appointment he has received. His is one of the many small, but great stories, of which the daily life of the Church is interwoven.

43-year-old Arjan Dodaj was born in Laç-Kurbin on the coast of Albania. He arrived in Italy as a migrant after crossing the Adriatic Sea on a boat. At the age of 16, he fled his country on a hot and starry night in September 1993, seeking a future and a way to help his poor family. He would work more than ten hours a day as a welder and gardener. Eventually, he came across a community that made him feel at home. There, he discovered the Christian faith, of which there was already a trace in his DNA thanks to the songs his grandmother used to sing. Pope St John Paul II ordained him ten years later as a member of the Priestly Fraternity of the Sons of the Cross, House of Mary Community, based in Rome. In 2017, he returned to his country as a *Fidei Donum* priest. This past 9 April, Pope Francis appointed him auxiliary bishop of the Archdiocese of Tiranë-Durrës.

Childhood

Arjan was born and raised in a communist, Albanian family. His education was atheistic. "I was born in a context where, unfortunately, every sign that recalled the faith was banned. In the first years of my life, I never heard of God's existence. My parents unfortunately endured, in a terrible way, the effect of communism. But my grandparents prayed to the Lord".

It was Arjan's maternal grandmother who instilled in him the first words of faith. "My first encounter with the things of God is like a refrain inside my head, inside my soul. Despite the threats, my grandmother was totally free in living a life of prayer. In their day, not knowing how to write, they learned their prayers by singing. And so, by learning prayers that rhymed, they knew doctrine. Only when I arrived in Italy did I discover that many things, about the sacraments for example, she had told me about them while singing at home, while working, while cleaning. She sang. That's how I learned too. I learned the second part of the Hail Mary. She always made me say the second part. That's how God worked with me."



Migrant

"I arrived in Italy right after the fall of Communism", says the newly elected Bishop. "At that moment it was not possible to obtain regular visas. The only way was by motorboat. Unfortunately, there were some boats that left, which, alas, did not arrive".

Shortly after the fall of communism, Arjan tried to leave the country. "Like many other boys, I had made many attempts. One of the first times, the boat was damaged.... Today, I thank the Lord that it didn't depart, because I don't know what would have happened to us - we were all crushed together, crowded together. Indescribable adventures, a real exodus. Then in the following attempts, I was able to get on one of those boats that left from the coast of my city, from this very beautiful lagoon, where I had gone many times as a child. We left the night of 15 September 1993. Thank God, the sea was very calm. The Lord preserved us. I remember very well that at that moment, it was my whole existence that was migrating. My story, as it were, was leaving that coast, with that night sky full of stars. I felt a tear inside me of those bonds, with my life, with my family".

Reflecting on that experience the new Auxiliary Bishop of Tiranë points out: "Today, many people are seen arriving on the boats. I think one should think of their tears, their sacrifices, the very painful vicissitudes they are living. They wouldn't be coming if their lives were not painful".

Some of Arjan's friends had emigrated to Italy shortly before him. Thanks to them, Arjan found refuge in Dronero, in the northern Italian province of Cuneo, near Turin. There he became an apprentice to a welder. "We used to weld bicycle frames. Then I also did many other jobs, in construction and gardening. This way, I could help support my family because we were really very poor". Other friends invited him to a meeting in the parish. "I worked a lot, sometimes even

more than ten hours a day. So, in the evening I would arrive home tired. I didn't have many friends. They told me that there was a nice group of young people in the parish, led by Father Massimo, who was a member of the House of Mary Community. I had a really good time! I found the support I needed in that very delicate phase of my youth".

Believer and priest

Arjan was baptized in 1997. Later, he asked to be welcomed into the Priestly Fraternity of the Sons of the Cross, House of Mary Community, in Rome. There, he studied to become a priest. This decision was difficult for his parents to accept. Ten years after he landed in Italy, it was Pope John Paul II who laid his hands on his head in St. Peter's Basilica.

"In 1993, the year I arrived in Italy, St. John Paul II visited Albania. The country had just come out of dictatorship. It seemed like an open trench. There was a lot of misery and poverty, but at the same time a thirst for novelty. I too, like many children and many other people, remember all the people who accompanied the Pope's car along the side of the roads from Tiranë to Shkodër. He has always accompanied me, and so has our holy Mother Teresa. As we were leaving the dictatorship, she poured out on us that balm of tenderness, of love, of goodness, of hope that she knew how to give to so many poor people in various parts of the world".

Father Dodaj worked in various parishes and became chaplain of the Albanian Community in Rome. In 2017, the Archbishop of Tiranë, George Anthony Frendo, asked Father Arjan to serve in the archdiocese. Both the superior of the House of Mary Community, Father Giacomo Martinelli, and the Cardinal Vicar of Rome, Angelo De Donatis, agreed. The priest returned to his country as a *Fidei Donum* priest, that is, as a priest temporarily providing service in a diocese other than the one in which he is officially incardinated.

Bishop

About his appointment as auxiliary bishop, Father Dodaj said, "Honestly, I never, ever thought about it or desired such a thing. I was very happy to live in a parish context, the daily family context that I have always lived, with my community, with the parishioners with the people entrusted to us. Now I have received this further call, this appointment of the Holy Father Pope Francis. I have welcomed it with trust in the Lord, in Our Lady, and with obedience to the Church".

Albania was the first European country visited by Pope Francis. It has always been a symbol of successful coexistence among peoples professing different religions. Christians of other confessions and Muslim believers are also rejoicing with the Pope's choice. Father Dodaj clarifies the type of "coexistence" that his country enjoys: "It is not religious tolerance. It is very important to change words and understand that for us it is harmony, familiarity, a spirit of great collaboration and mutual support".

On the Fittingness And Faithfulness Of The Immaculate Conception

By Msgr. Charles Pope

Tuesday's Solemn Feast of the Immaculate Conception is often mistakenly thought to refer to the conception of Jesus in the womb of the Blessed Mother. It does not. Perhaps it does not help the confusion that the Gospel chosen for today's feast is in fact the gospel of the Annunciation wherein Jesus is conceived in Mary's womb by the power of the Holy Spirit. There is a reason this Gospel is chosen as we shall later see. However, the Dogma of the Immaculate Conception refers to Mary's Conception in the womb of her mother Anne. The Dogma is stated as follows in the Papal Document *Ineffabilis Deus* issued by Pope Pius IX in 1854:

The Most-holy Virgin Mary was, in the first moment of her conception, by a unique gift of grace and privilege of Almighty God, in view of the merits of Jesus Christ, the Redeemer of Mankind, preserved free from all stain of Original Sin (D 1641).

Note how carefully the Dogma is worded. Mary receives this gift from God on account of the merits of Jesus Christ. Hence we do not teach that Mary was not in need of the saving grace of Jesus Christ, for it is only by his merits that she is able to receive this gift.

Why does the Church teach this? Perhaps we can look at it from three perspectives:

1. Fittingness— When we consider the fittingness of something we do not deny that God could have done things otherwise. We argue only that what he did makes sense and is in accord with what seems best. For example, Jesus could have chosen to appear on earth as a full-grown man, never having

been born, never having been a child or a carpenter. It was surely possible for God to have done this. He could have created a human nature for himself *ex nihilo* (from nothing). However it seems fitting that the Lord Jesus lived life as we do, having been conceived, born, raised, nurtured, come to manhood, labored, and finally ministered. So the Lord chose to have for himself a mother and, from this mother, to draw his humanity.

But what sort of humanity would he need to draw from her? It seems clear that the humanity he drew from her had to be sinless since Scripture says of Jesus: *For we do not have a high priest who is unable to sympathize with our weaknesses, but we have one who has been tempted in every way, just as we are—yet was without sin.* (Heb 4:15). And again, *Which of you can accuse me of sin?* (John 8:46). So the humanity that Christ drew from Mary was sinless. But Mary cannot give what she does not have. So it is fitting that God preserved her at her conception from the stain (*macula*) of Original Sin. Hence she is called *Immacula* (without stain).

Now one might argue that God could simply have done for Christ what he did for Mary and simply intervened at the moment of Christ's conception and preserved him free of that stain while leaving Mary with it. This is true, but less fitting. For if Christ did not take all of his humanity from Mary then incarnation becomes something of a charade, incomplete at best. Christ would have taken some of his humanity from Mary and some from.....where? Hence it is more fitting that Mary be preserved and that Christ's



sonship of Mary be full and her Maternity be full.

It is also fitting that Mary be preserved from Original Sin due to her status as the New Eve. Mary fulfills the text of Genesis 3:15: *And I will put enmity between you and the woman, and between your offspring and hers; he will crush your head, and you will strike his heel.* So Mary is the woman, the new Eve, spoken of in this text. But the first Eve was created sinless. Hence it is fitting that the second Eve also be created sinless. In effect, God is revisiting the original scenario wherein we were harmed by a man, a woman, and a tree. Hence God decrees that we would be restored in the same way: a man (Christ), a woman (Mary), and the tree of the cross. Hence Christ saves us by the wood of the Cross and his obedience. But, just as the original scenario also featured a sinless woman who disobeyed, now another sinless woman would, this time, obey. It is thus fitting that Mary be sinless as the New Eve.

2. Faithfulness to Scripture – The Gospel chosen for today may confuse some for it is

the gospel that refers to Christ's conception. However it is chosen for the fact of what the Angel Gabriel says to Mary: *And coming to her, he said, "Hail, full of grace! The Lord is with you (Lk 1:28).* There is a Greek word underlying the translation "full of grace" and the word is *kecharitomene*. The meaning of this term is much disputed since it is a *hapax legomenon* (a word that only occurs once in the whole of Scripture). The great scholar, Greek speaker and Father of the Church Origen said of this word: *The angel greeted Mary with a new address which I could not find anywhere else in scripture... This greeting was reserved for Mary alone (Hom 6.7 on Luke).*

However, at the heart of the word is the Greek word *charitoo* which means to show forth grace (*charis*), or in the passive to have grace shown. *Kecharitomene* is a perfect, passive, participle of *charitoo* and hence means endowed with grace (*charis*). But what does it mean to say it is a perfect participle? A participle is a word that has both the qualities of an adjective and a verb. The 'perfect' action of the participle is considered to have been completed before the time of the speaker. How long before is not a consideration, but the Greek verbal idea is that the action has already been completed. Perfected action must imply the past in relationship to the speaker. Thus, Gabriel in using the word is confessing that Mary had already been graced. So, the most literal rendering of *kecharitomene* is "having been endowed with grace." That is awkward in English however: "Hail! having been endowed with grace, the Lord is with thee!" So the more standard and still literal way is "full of grace." Attempts to render the word more vaguely as, "highly favored" do not respect the root word *charito* and *charis* which is almost always rendered as "grace" and not mere favor. The plain meaning of *charis* is grace.

Now, grammar aside, it would be strange for Gabriel to say to a woman who had Original

Sin that she was full of grace. In no way can the word be implied to mean that she will one day be graced since it is a past participle. The action of her being made full of grace is past, though its effects are present now. So Gabriel is greeting her in this condition. Hence the text implies some prior action of God. Now, this does not *ipso facto* prove that the moment in the past where God acted was her conception. But, this seems the most fitting timing since Original Sin is contracted at that moment. Gabriel's greeting only makes sense if Mary is free from Original Sin, for grace and Original Sin are not compatible

But the point remains that Catholic teaching on Mary's freedom from Original Sin is most faithful to the Scriptural text here. The Angel's greeting is significant and Catholic teaching best connects the dots, and takes the greeting at its word, respecting its plain meaning. Mary, having been made full of grace, is free from Original Sin.

3. Fathers of the Church– The Church Fathers did not use the term Immaculate Conception but they did teach on Mary's holiness and sinlessness. Here are some quotes:

St. Ephrem, 3rd Century – *Thou and thy Mother are the only ones who are totally beautiful in every respect; for in thee O Lord there is no spot and in thy Mother, no stain. (Carmina Nisibena, 27.8).*

Hippolytus 3rd Century – *The Lord was sinless, because in His humanity He was fashioned out of incorruptible wood, that is to say, out of the Virgin and the Holy Spirit (In Psalm 22; quoted by Theodoret, Dialogus 1; PG 10:610, 864-5)*

St. Augustine 4th Century – *All men must confess themselves as sinners except the Holy Virgin Mary, whom I desire for the sake of the honor of the Lord to leave entirely out of the question when the talk is of sin. For from Him we know what abundance of grace*

for overcoming sin in every particular was conferred upon her who had the merit to conceive and bear Him who undoubtedly had no sin." (De Natura et gratia 36.42)

St. Ephrem, 3rd Century – *Mary and Eve, two people without guilt, two simple people were identical. Later however, one became the cause of our death, the other the cause of our life (Opus Syr. II, 327)*

Origen, 3rd Century – *This Virgin Mother of the Only-begotten of God, is called Mary, worthy of God, immaculate of the immaculate, one of the one. (Homily 1)*

St Ambrose - 4th Century – *"Mary, a Virgin not only undefiled but a Virgin whom grace has made inviolate, free of every stain of sin." (Sermon 22:30)*

In the end, Mary receives this honor to be free of original sin for the sake of Christ. All the great Marian doctrines refer back to Christ. Mary too, as the perfect disciple, and Mother of the Church also prefigures the gifts that we will one day enjoy. For, in heaven, having been freed of all our sins and purified by the blood of Christ, we too will be rightfully called Immaculate (without stain). So Mary's Feast is ours too by way of promise.

There is a beautiful text for today's feast which says,

*Tota pulchra es, Maria,
et macula originalis non est in te.
Vestimentum tuum candidum quasi nix, et
facies tua sicut sol.
Tu gloria Jerusalem, tu laetitia Israel, tu honorificentia populi nostri.
Tota pulchra es, Maria.*

You are all beautiful, Mary, and the original stain [of sin] is not in you. Your clothing is bright as snow, and your face is like the sun. You are the glory of Jerusalem, you are the joy of Israel, you give honour to our people. You are all beautiful, Mary.

THE SPIRIT OF CHRIST

By Dan Burke

Presence of God – O Holy Spirit, You who had complete dominion over the holy soul of Jesus, deign to direct my poor soul.

MEDITATION

In Sacred Scripture, the Holy Spirit is called “the Spirit of Christ” (Romans 8:9), an expression that is pregnant with meaning. Christ is the Incarnate Word. Although He became Man, He remains the Word, the Son of God. From Him, as from the Father, the Holy Spirit proceeds; therefore, the Holy Spirit is properly termed the Spirit of Christ, because the Person of Christ is none other than that of the Word. When we speak of Christ, however, we do not speak of Him as God only, but also, and especially, as Man, that is, as the Incarnate Word. In this sense too, it can be said that the Holy Spirit is the Spirit of Christ. We know, in fact, that the divine Paraclete, with the Father and the Son, dwells in every soul that is in the state of grace, and not only does He dwell there, but He delights to abide there. The higher the degree of grace He finds in a soul, the greater is His delight, for wherever grace is more

abundant, there is a more intense and luminous reflection of God’s nature and goodness. This is why the Holy Spirit took such great complacency in the soul of the Blessed Virgin, who, although she was full of grace, continually grew from plenitude to plenitude. Yet the grace possessed by Mary was but a pale reflection of the grace which filled the soul of Jesus, grace which theologians call “infinite.”

If then, Jesus possessed grace in an infinite manner, it can be said that the Holy Spirit took complacency in the soul of Christ in an infinite manner and dwelt there as in His temple of predilection. This idea is expressed in the *Encyclical Mystici Corporis* when it says that the divine Paraclete “finds His delight in dwelling in the soul of the Redeemer as in His favorite temple.” And if we can say that the Holy Spirit is ours because He dwells in our souls sanctified by grace, with infinitely greater reason can we say that He is “Christ’s,” whose sacred soul possesses grace in an immeasurable degree.

COLLOQUY

“O Holy Spirit, only Your clemency and ineffable love could have held the Son of God



(Christ the King Catholic Church
(Ann Arbor, Michigan) – interior Holy Spirit window)

nailed to the wood of the Cross, for neither nails nor cords would have been able to hold Him there without the bonds of love. And then, when Christ returned to His Father at His Ascension, You, O Holy Spirit, were sent into the world with the power of the Father, the wisdom of the Son, and Your own mercy, to strengthen the way of the doctrine which Christ left in the world.... O Holy Spirit, come into my heart; by Your power, draw it to You, true God; grant me charity with fear, guard me from every evil thought, warm me, inflame me with Your most sweet love, so that every pain will seem slight to me. O Holy Father and my sweet Lord, help me now in all my actions” (St. Catherine of Siena).

“O Jesus, I offer You my poor love, placing it in the arms of Your ardent Spirit, in the furnace enkindled by Your love. O my Beloved, by Your divine power prepare me for spiritual warfare with the weapons of

Your Spirit, since I do not rely upon myself, but on Your goodness alone. By Your unfathomable charity, root out of me anything that is not wholly Yours, so that, by the grace of Your love, invited and restored by Your loving sweetness, I may love You alone. The sweet outpourings of Your Spirit make the burden of life seem brief and light. Deign to cooperate with my works, so that my soul may magnify You eternally. May my life be consecrated to You, and may my spirit rejoice in You, my Savior; then every thought and act will be praise and thanksgiving to You” (St. Gertrude).

O Holy Spirit, You who worked with such plenitude in the most holy soul of Jesus, deign to operate also in my poor soul and take it entirely under Your direction, so that every act, interior as well as exterior, may be according to Your inspirations, Your choice, Your good pleasure.

SHE IS ONLY ASLEEP

By Elizabeth Mitchell

It takes a great deal for the Lord to wrestle us from our own hands. Death, it seems, is often the door through which God has to make us walk in order that we rely completely upon Him.

In a touching scene recounted in the synoptic Gospels, the young daughter of Jairus, a ruler of the synagogue, lies dying, and Jairus hurries to seek Christ's help. (Cf. Matthew 9:18-16; Mark 5:21-43; Luke 8:40-56.) "My little daughter is at the point of death. . . . But come and lay your hands on her, so that she may be made well." (Mark 5:23)

As Christ starts off with him, relief must have flooded over this good, believing man. And then, the Lord gets delayed. The woman with the hemorrhage steps forward through the crowd and seems to claim the anticipated miracle. Anxiety and despair must have flooded over the waiting father. He seems to have lost his chance. "While Christ was still speaking, there came from the ruler's house some who said, 'Your daughter is dead. Why trouble the Teacher any further?'" (Mark 5:35)

Knowingly, Christ turns to Jairus and says, "Do not fear, only believe." (Mark 5:36) Only believe.

A similar scenario presents itself to Mary and Martha, whose brother Lazarus languishes and then dies while they wait for Christ to arrive. "Lord, if you had been here, 'my brother would not have died.'" (John 11:21) Christ allows them to lose the very thing they hoped for, a healing, in order to test their faith in the greater miracle, a resurrection. The process is excruciating.

But Martha proclaims her willingness to believe through the impossible. "Even now, I know that whatever you ask from God, God will give you." (John 11:22)

Even now.

Both Jairus and Martha have heard the Lord's "not yet," seen the blessing pass them by, and been left with death and failure, disappointment and regret. Yet if we stay with them in faith, we realize that Christ delays in order to give the greater gift.

Christ intentionally tarries, delaying his arrival at the place of need, "So when He heard that Lazarus was ill, he stayed two days longer

in the place where He was." (John 11:5) He needs us to trust Him through the apparent loss in order to place ourselves entirely in His own, loving hands. "I am glad for you that I was not there that you may believe." (John 11:15)



The Raising of Jairus' Daughter by Gabriel Max, 1878
[Montreal Museum of Fine Arts]

St. Paul relates that in his own sufferings for Christ, he was likewise left for dead in order to rely solely on God. "We were so utterly, unbearably crushed that we despaired of life itself. . . .to make us rely not on ourselves but on God who raises the dead." (2 Cor 1:8)

In today's pandemic climate, we are faced with a similar challenge in the Church. The silencing of the liturgy, snuffed out around the globe, has left the Church in a deadening slumber. Discouragement is felt palpably among the pastors at the anemic response to the re-opened Mass, the decline of sacramental life, and collections all but dried up. They have no more wine.

The civil strife and violence unleashed around the globe, furthermore, is partly - but undoubtedly - one result of the void of grace created on the earth by the absence of the Holy Sacrifice of the Mass. We removed Christ from our midst, not comprehending how fully the Eucharist was silently emanating power, protection, grace, goodness, forgiveness, and anointing throughout the world. "The world could survive more easily without the sun," St.

Padre Pio once noted, "than survive without the Holy Sacrifice of the Mass."

But *even now*, Christ has resurrection in store.

"She is not dead, she is only asleep," Our Lord declares to those mourning in the room of

Jairus' daughter. (Mark 5:39) "Our friend Lazarus has fallen asleep, but I go to awaken him out of sleep." (John 11:11)

Just so Christ calls to Peter in Gethsemane, "A few moments ago you boasted that you would die with me, and yet Simon are you sleeping? Now I am pursued to the death . . . and Simon are you sleeping?" (Cf. St. Thomas More, *De Tristitia Christi*)

Christ comes now to wake us from the slumber of death. He stretches out his hand and commands us to live: "Little girl, I say to you, arise!" (Mark 5:41) "Lazarus, come out!" (John 11:43)

And to His apostles in the Garden, so also to His Church: "Rise! Let us be going; see my betrayer is at hand." (Mt 26:46)

It is at the threshold of death, when the darkness has enveloped the light and the Garden is overrun by the Enemy, that Christ calls forth the miracle. He allows the death in order to perform His resurrection, if we will fear not and *only believe*. The hour may be late, the betrayer may be at hand, but the gates of Hell will not prevail. The Church is not dead, she is only asleep. *Talitha cumi!*

Shenjtëreshë për Dashuri

Dr. Mons. Lush Gjergji

Nënë Tereze Bojaxhiu e kam takuar shumë herë gjatë njohjes, shoqërimit dhe bashkëpunimit me të, në meridianët të ndryshme të botës, që nga takimi im i parë personal në Romë më 29 mars 1969. Unë atëherë isha student i vitit të dytë të filozofisë në Universitetin “Urbanian”. Atë e kam shoqëruar në pesë vizitat e saja në Kosovë, 1970, 1978, 1980, 1982, 1986; isha me të gjatë Shpërblimit Nobel për Paqe, në Oslo, (10 dhjetor 1979); në shumë vende të Evropës Lindore; sidomos në Kalkutë dhe në rrethinë (1989)...

Çdo takim ishte si i pari dhe i fundit, që më bënte përshtypje thjeshtësia, çiltëria, mirësia, bujaria, duresa, shenjtëria, kujdesi dhe dashuria për të varfër ndër më të varfër, të gërbulur, ata që askush nuk i donte, sidomos malli për Atdhe, lidhja e ngushtë shpirtërore me Popullin dhe Kishën ndër Shqiptarë, por edhe vuajtja me ne dhe për ne, për njerëzit e mbarë botës.

Gjithnjë kam studiuar dhe hulumtuar për rrënjët, burimin, zanafillën e këtij përkushtime dhe dashurie kaq prekëse dhe tërheqëse për mbarë botën.

Përfundimi im është ky: janë dy burime unike që e kanë përgatitur dhe dhuruar atë gjithë botës: tradita dhe përvoja kombëtare shqiptare dhe familjare, që mbështetet në këtë parime të shenjta dhe domethënëse: “*Bukë, krip dhe zemër*”, dhe: “*Shtëpia është e Zotit dhe mysafirit*”;

si dhe përvoja dhe jeta e dashurisë së krishterë në familje dhe në bashkësi famullitare, kur Jezusi identifikohet me çdo njeri: “*Çka do bëjë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjlit, e bëjë për mua*” (Mt 25, 40).

Ajo ishte *Dashuria në veprim*, siç e kam definuar unë. Me 17 libra kushtuar Nënës Tereze, të përkthyer në shumë gjuhë botërore, jam munduar t’i dokumentoj dhe argumentoj këto dy burime të pashtershme për Nënë Tereze: Zotin - Dashuri dhe vëllaun apo motrën Njeri.

1. Disa risi në jetën dhe veprën e Nënës Tereze: feja, shpresa dhe dashuria

Ndër risitë më të rëndësishme që kam hetuar unë janë këto: feja - që për Nënë Tereze ishte kërkim i Zotit në Njeriun dhe i Njeriut në Zotin në çdo



fazë të jetës së saj. E kishte kërkuar Zotin dhe thirrjen, planin e tij prej moshës 12 deri 18 vjeçare, kur kishte vendosur plotësisht t’i kushtohet atij: “*Dua të bëhem motër misionare për t’i ndihmuar të varfrit e botës*” (Letnicë, 14 gusht 1928). Gjatë 18 viteve si “*Motër e Loretos*”, dhe së fundi prej vitit 1950 e deri te kalimi në amshim, 5 shtator 1997. Kurrë nuk e ka ndarë Zotin prej Njeriut dhe Njeriun prej Zotit.

Shpresa – veprim gjithnjë dhe kudo me

dashuri dhe për dashuri, me parimin: “*Kudo që jeta është në rrezik, aty duhet të jemi ne.*”

Dashuria – flijim dhe dhurim pa kursim për t’u bërë dhe mbetur Nëna e Dashurisë.

2. Nëna universale – universalizmi i jetës dhe dashurisë

Misioni i Nënës Tereze është Dashuria, vend-veprimi është bota, mbarë njerëzimi, metodologjia është dëshmia e krishterë,

qëllimi është lehtësimi dhe pakësimi i vuajtjeve, mënyra është pjesëmarrja e plotë dhe e lirë në jetën e tyre, të privilegjuar janë të braktisurit dhe të dëbuarit e botës.

Risia e dytë e Nënës Tereze ishte UNIVERSALIZMI në çdo kuptim dhe drejtim kohor dhe hapësinor në dy parime themelore: Për Zotin – Dashuri dhe Njeriun – vëlla apo motër, pra, i jetës dhe dashurisë. Askush në historinë e njerëzimit, as në atë të krishterimit, nuk kishte nisur dhe zbatuar një vepër të tillë pa kurrfarë përjashtimi kombëtar, fetar, gjinor, kastor, shoqëror, dhe vetëm ajo kishte arritur që t'i bashkonte të gjithë, hinduistët, budistët, myslimanët, të krishterët, ateistët, gnostikët, me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë. Ajo nuk kishte për qëllim kthimin e të tjerëve në fenë e krishterë, në Kishën Katolike, por “*që të jetë në mesin e tyre rrezja e Pranisë dhe e Dashurisë së Zotit, që t'ua dhurojnë të gjithëve Zotin – Dashuri – Atë*”

Qëllimi i saj, pra, ishte diçka tjetër, dashuria dhe prania e Zotit në botën e sotme, sidomos ndër të varfrit më të varfër, të braktisur, të gërbulur, njerëz të përbuzur dhe të përjashtuar nga jeta e rëndomtë, për t'ua dëshmuar të gjithëve se çdo njeri është së pari Njeri, i afërm ynë, vëlla apo motër, deri te ajo që në çdo Njeri ta shohim, njohim, duam dhe shërbejmë vetë Jezusin, dhe këtë me shembullin e jetës dhe dëshminë e përditshme.

Ja çka thotë Nëna Tereze për motrat që i ka themeluar ajo me emërtim “MISIONARET E DASHURISË”: “*Misionarja e Dashurisë duhet dhuruar, por mbi të gjitha duhet ta dhurojë vetveten... Për t'iu dhuruar të varfërve dashuri, ne duhet të jemi të afta të duam njëra-tjetrën në bashkësinë tonë rregulltare, t'i dhurohem tërësisht Zotit nëpërmjet të afërmit, nevojtarit...*”.

3. Vuajtja – bekim e jo mallkim

Risia e tretë e Nënës Tereze është kjo: vuajtja, pësimi, mjerimi, varfëria, gërbula, Sida, si dhe çdo pësim tjetër, nuk është mallkim, dënim i Zotit, por hir, mundësi për ta treguar dashurinë ndaj Jezusit që vuan në njerëz të tillë.

Ajo thoshte kështu: “*Të varfrit na japin ne shumë më tepër, na dhurojnë mundësinë që konkretisht ta duam dhe ta shërbejmë Jezusin i cili pëson në ta. Ata na japin falënderimin... Paqja do të vijë në botë nëpërmjet të varfërve. Të varfrit janë të detyruar të jenë të tillë, ndërsa ne jemi të varfra për dashuri ndaj Jezu Krishtit dhe për t'i kuptuar deri në fund ata që nuk kanë asgjë duke jetuar si ata dhe me ata... Jepni duart tuaja për shërbim të varfërve, zemrën tuaj për t'i dashur të varfrit. Dashuria e vërtetë është gjithmonë flijim dhe dhurim*”.

4. Dhurim falas dhe në tërësi

Risia e katërt e Nënës Tereze është dhurimi falas dhe në tërësi, me dashuri dhe për dashuri, me hare dhe falënderim. Ajo shpeshherë thoshte kështu: “*Nëse nuk mund të bësh asgjë për të tjerët, atëherë së paku buzëqeshu, sepse kjo nuk të kushton asgjë, por jep shumë. Gëzimi duhet të jetë një ndër thesaret e jetës sonë... Kështu më thoshte Nëna Loke: “Gonxhe Gjyli, bija ime, ose bëre këtë punë me zemër, ose mos e bën aspak!”*

Dhe vazhdon kështu: “*Unë ju kam thënë motrave përgjegjëse për bashkësitë tona: Bota është plot mjerime, vuajtje, pikëllime. Ne duhet të dalim në botë për ta pakësuar vuajtjen, për të qenë rrezja e Dashurisë së Zotit. Ata që vuajnë duhet të gjejnë në ne Ungjillin ngushëllues... Çdoherë kur e takoni Jezu Krishtin në të varfër, buzëqeshini. Nëse nuk doni t'i buzëqesheni Jezusit në të varfër, më mirë mos dilni fare ose kthetuni së shpejti në kuwend...*”.

Dhe ja, prapë mrekullia e dashurisë dhe e shenjtërisë: Më e varfra e botës, Nëna Tereze, më së shumti i ka ndihmuar të varfrit e botës, jo vetëm në anën materiale, por edhe më tepër në atë shpirtërore, sepse është dhuruar falas dhe tërësisht, me gëzim dhe me dashuri të plotë Zotit nëpërmjet njeriut.

5. Kontemplative - aktive në botë

Risia e pestë e Misionareve të Dashurisë është kjo: të jenë kontemplative aktive në botë. Kjo do të thotë të jenë tërësisht të kushtuara Zotit në lutje, meditim, adhurim, pendesë, dhe si pasojë e kësaj jete shpirtërore, të jenë edhe aktive në botë me dashuri vepruese. Pse dhe si?

“*Të gjitha për Jezusin, në Jezusin dhe me Jezusin*”.

Urata, meditimi, adhurimi, mesha, kungimi, me një fjalë e tërë jeta shpirtërore ka për qëllim që motrat të aftësohen për dashuri, për dëshmi, për veprim, për ta njohur, ndihmuar, dashur dhe shërbyer Jezusin në njerëz që vuajnë.

Kontemplative- aktive domethënë ta kërkojmë, gjejmë, shërbejmë Zotin jo vetëm në çaste të kushtuara atij, në jetën tonë shpirtërore, por gjithkund dhe gjithnjë, pikërisht me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë.

Nëna Tereze thoshte: “*Nëse e njohim, duam, adhurojmë, ushqehemi me Jezu Krishtin vetëm në meshë, në Kungim, është tepër pak. Ne lutemi, meditojmë, adhurojmë, marrim pjesë në meshë, e marrim Jezusin në Kungim në zemër për ta vazhduar këtë kërkim dhe shoqërim me të në përditëshmëri. Nëse e gjejmë dhe shërbejmë Jezusin në të varfërit tanë, atëherë jemi kontemplative në mesin e botës. Gjithnjë e shërbejmë Zotin. Nuk kam nevojë për lutje për ta gjetur Zotin. Atë e gjejmë në punë, në veprimtari të rëndomta... Prej Jezusit në Eukaristi kalojmë në Jezusin Vëlla apo Motër – Njeri...*”

Ndërsa bashkësitë tjera rregulltare ndahen në dy kategori, aktive apo vepruese në botë, nëpër famulli, shkolla, spitale, institucione të ndryshme, dhe kontemplative, të mbyllur dhe të kushtuar tërësisht vetëm jetës shpirtërore, Nëna Tereze ka gjetur modelin e ri që këto dy lloje jete dhe kushtimi të bashkohen në një me harmoni dhe veprimtari mahnitëse.

Nga kjo përvojë e madhe thoshte: “*Sa më tepër që lutemi, adhurojmë, aq më shumë kemi kohë për të varfërit, sepse jeta shpirtërore na i hapë sytë, mendjen, zemrën, duart, e shton dashurinë ndaj të tjerëve, e bënë më të gjallë pravinë e Jezu Krishtit në të tjerët, na lidh me Zotin dhe me të afërmin. Ne nuk jemi punëtorë shoqërorë. Ne kemi një jetë kontemplative. E kërkojmë, adhurojmë Jezu Krishtin në Euharisti dhe në të varfër të braktisur, në çdo njeri*”.

Për këtë Nëna jonë Tereze ishte dhe gjatë do të mbesë “*Ungjilli i gjallë*”, risia unguillore dhe “*Misionarja e Dashurisë*”, Nëna e botës së mjerimit, tash Shenjtëresha e Dashurisë.

Prishinë, 2 shtator 2020

A SPECIAL POWER OF LOVING: MOTHER TERESA'S LETTER ON WOMEN

By Clair Dwyer

The lines of division in our country and in the world are marked and clear and widening by the hour.

“I call heaven and earth to witness against you this day, that I have set before you life and death, blessing and curse, therefore choose life, that you and your descendants may live.” (Deut 30:19)

It is a clear choice for some of us, but for so many, what is good and true and beautiful is shrouded in a kind of haze of ambiguity and confusion and complexity.

But God? God is simple. And when He speaks, there are no trap-door meanings or manipulated words. Love is love, marriage is marriage, life is life—choice and rights and freedom and family and fatherhood and femininity—they all mean what they were created to mean, undistorted by the one who lies for a living.

So I love it when I find someone unafraid to say it like it is. To be the child on the street pointing out the embarrassingly obvious: that the emperor has no clothes. That there is no substance behind the wagging signs and slogans and mantras of movements which purport to be vaguely Christian but really are houses of cards built on nothing but sand.

The feast day of St. Teresa of Calcutta is approaching on September 5. Simple, direct, unassuming, and totally unafraid, this little nun captivated us with her love—but also with her healthy dose of truth. She made world-leaders shift uncomfortably in their seats (if not in their consciences). And do we *ever* need her intercession today.

There is a little-known letter written by this diminutive powerhouse that I want to share with you. It's timely not just because of her approaching feast day, but also because this month marks the twenty-fifth anniversary of its writing.

Twenty-five years ago, the United Nations held its Fourth World Conference on Women in Beijing, China (ironically—China, of all places, where millions of women are aborted and brutally and coercively sterilized every year) and before it began in 1995, the Church could already anticipate what was coming.

Preparatory meetings drafted documents to be ratified at the conference—documents that confirmed the worst fears of pro-life and pro-family delegates from around the world (including representatives of the Vatican). Documents that wove words like “sexual and reproductive rights” throughout, veiled terms for “abortion.” Documents that willfully disregarded the complementarity of men and women, the support of traditional motherhood, and the right to life. Documents that introduced dangerously cryptic terms like “gender” and opened a Pandora's box of demonic consequences. Documents that threatened to unravel common sense and universal experience—and everything we hold sacred regarding femininity and the family.

So the summer before the conference opened, Pope John Paul II wrote his famous Letter to Women—warm and personal, he thanked women for their distinctive contributions to the family, to the Church, to the world. He held up the uniqueness of a woman's nature as something to be celebrated. He hoped for an authentic freedom for women everywhere—not to be like men, but to be wholly and fully women, living the entirety of the Gospel. He prayed that the conference would “bring out the full truth about women.” But he wanted a woman's voice to share the Church's platform. And so he turned to Mother Teresa and asked her to write a letter, too.

The letter was typed, signed, and sent to the Vatican. On her way to the conference, which was to begin September 4, 1995, Mercedes Arzu-Wilson, a member of the delegation

from Guatemala and a friend of Mother Teresa, stopped in Rome to pick it up.

The letter was handed off to pro-life lobbyists who had secured, thanks to a helpful hotel manager, what appeared to be the only available photocopy machine available in the entire city. Running that machine out of their hotel room throughout the conference, volunteers copied thousands and thousands of pro-life, pro-family, and pro-woman flyers on reams of multi-colored paper which members of sympathetic delegations had snuck into their luggage.

The decision was made to copy the letter from Mother Teresa in all six of the official United Nations languages: English, French, Spanish, Russian, Chinese, and Arabic. Pro-life translators were found for each language. But the existence of the letter was kept a secret so that pro-abortion forces would be caught off-guard when Mercedes Arzu-Wilson delivered it in a press conference on September 12, 1995.

The letter read:

Dear Friends,

I am praying for God's blessing on all who are taking part in the Fourth World Conference on Women in Beijing. I hope that this Conference will help everyone to know, love, and respect the special place of women in God's plan so that they may fulfill this plan in their lives.

I do not understand why some people are saying that women and men are exactly the same, and are denying the beautiful differences between men and women. All God's gifts are good, but they are not all the same. As I often say to people who tell me that they would like to serve the poor as I do, “What I can do, you cannot. What you can do, I cannot. But together we can do something beautiful for God.” It is just this way with the differences between women and men.


God has created each one of us,

every human being, for greater things— to love and to be loved. But why did God make some of us men and others women? Because a

have often said, abortion is the greatest destroyer of peace in the world today, and those who want to make women and men the same are all in

love and peace with one another and make our families and our world something beautiful for God.

Let us pray.



woman's love is one image of the love of God, and a man's love is another image of God's love. Both are created to love, but each in a different way. Woman and man complete each other, and together show forth God's love more fully than either can do it alone.

That special power of loving that belongs to a woman is seen most clearly when she becomes a mother. Motherhood is the gift of God to women. How grateful we must be to God for this wonderful gift that brings such joy to the whole world, women and men alike!

Yet we can destroy this gift of motherhood, especially by the evil of abortion, but also by thinking that other things like jobs or positions are more important than loving, than giving oneself to others. No job, no plans, no possessions, no idea of "freedom" can take the place of love. So anything that destroys God's gift of motherhood destroys His most precious gift to women— the ability to love as a woman.

God told us, "Love your neighbor as yourself." So first I am to love myself rightly, and then to love my neighbor like that.

But how can I love myself unless I accept myself as God has made me? Those who deny the beautiful differences between men and women are not accepting themselves as God has made them, and so cannot love the neighbor. They will only bring division, unhappiness, and destruction of peace to the world. For example, as I

favor of abortion.

Instead of death and sorrow, let us bring peace and joy to the world. To do this we must beg God for His gift of peace and learn to love and accept each other as brothers and sisters, children of God.

We know that the best place for children to learn how to love and to pray is in the family, by seeing the love and prayer of their mother and father. When families are broken or disunited, many children grow up not knowing how to love and pray. A country where many families have been destroyed like this will have many problems. I have often seen, especially in the rich countries, how children turn to drugs or other things to escape feeling unloved and rejected.

But when families are strong and united, children can see God's special love in the love of their father and mother and can grow to make their country a loving and prayerful place. The child is God's best gift to the family and needs both mother and father because each one shows God's love in a special way. The family that prays together stays together, and if they stay together they will love one another as God has loved each one of them. And works of love are always works of peace.

So let us keep the joy of loving in our hearts and share this joy with all we meet. My prayer for all of the delegates, and for every woman whom the Beijing Conference is trying to help, is that each one may be humble and pure like Mary so as to live in

*All for the glory of God
and good of souls.*

God bless you.

Mother Teresa, MC

And there you have it. Men and women, she says, are different. Can anyone really deny it? Women's maternity is a gift not only to the world but to *her*—it is, in fact, the way she was designed to love. To say otherwise is a lie and a distortion. "Did God really say..." Satan begins, and she shuts him down, I imagine, with her hand in the air: *Yes, He did. Isn't it obvious?* Case closed.

Those radical feminists who used the power of the UN to mainstream gender ideology and to advance abortion, birth control, and downplay the importance of marriage and the nuclear family were, of course, very successful. Yet, we know, as Mother Teresa knew, that in the end, such radical policies are doomed.

"Perhaps," reflected Martha Casco, a delegate from Honduras, "our greatest hope for stopping this absurd attempt to change human nature is women themselves. A woman's way of being is so deep, her love for life is so passionate and her longing to be a mother so strong that the feminist revolution is ultimately destined to fail."

"In the end," says the greatest Mother ever, "my Immaculate Heart will triumph."

Immaculate Heart of Mary, pray for us.

St. Teresa of Calcutta —
Mother Teresa—pray for us, our



**5 TETOR
1980**

MESAZHI I SHËN GJON PALIT II DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR

Më 5 tetor 1980, gjatë vizitës në Otranto të Italisë, nga brigjet e përtejme të Adriatikut, Papa Shën Gjon Pali II përshëndeti popullin shqiptar me një mesazh të parë plot dashuri atërore, duke shprehur kujdesin për grigjën e vogël, të martirizuar, të katolikëve, nën thundrën e diktaturës komuniste në Shqipëri.

Në homelinë e Meshës Shenjte, kremtuar më 5 tetor 1980 në Otranto, kushtuar martirizimit të të krishterëve në shekuj, Papa Wojtila sensibilizoi mbarë botën me fjalët drejtohet popullit shqiptar:

“E kështu sot nuk mund të mos e hedh vështrimin përtej detit, ku Kisha heroike e Shqipërisë tronditet thellë nga persekutimi i gjatë, por edhe pasurohet nga dëshmia e martirëve të saj; ipeshkvij, meshtarë, rregulltarë, rregulltare e besimtarë të thjeshtë”...

Me këtë rast edhe një herë duam të kujtojmë me nderim e mirënjohje të veçantë veprimtarinë e Papës shën Gjon Pali II në favor të Shqipërisë, Kosovës e të shqiptarëve kudo që ndodhen. Po përmendim fjalët që vetë Ati i Shenjtë Wojtila pat thënë, së pari në sheshin Skënderbe të Tiranës, gjatë vizitës së tij historike e të paharruar të 25 prillit 1993, gjatë së cilës shuguroi katër ipeshkvijtë e parë shqiptarë të Kishës Katolike, pas komunizmit:

“Popull shqiptar, ec përpara me guxim drejt shtigjeve të solidaritetit. Është një rrugë e vështirë kjo, por në të janë mbjell farat e shpresës. Të shoqëroftë forca e martirëve të tu, dëshmitarë gjithmonë në roje të lirisë në vitet e pafund të shtypjes së regjimit totalitar.

T’i ndriçofte hapat e tu dashuria për familjen, shpirti i vëllazërimit, mikpritja ndaj të huajit dhe vetitë që e dallojnë popullin tuaj, veti këto që përbëjnë pasurinë

më të çmuar shekullore shqiptarë”.

E pastaj për Kosovën, sidomos kur në të ndizej lufta shqiptaro-serbe, që shkaktoi kaq viktima e sakrifica për popullin shqiptar të atyre trojeve, Papa shën Gjon Pali II, në mesazhin e tij Urbi et Orbi, pikërisht për Pashkët e vitit 1999, pati thënë:

“I lutem Zotit të ringjallur t’i japë dhuratën e paqes, së pari tokës së martirizuar të Kosovës, ku lot e gjak vazhdojnë të përzihen në një skenar dramatik urrejtheje dhe dhune. Mendoj për ata që janë vararë, për ata që kanë mbetur pa shtëpi, për ata që janë larguar me forcë nga familjarët, për ata që janë detyruar të ikin larg. Të mobilizohet solidariteti i të gjithëve, që më në fund të flitet sërish për vëllazërim e paqe! Si të qëndrojmë pasivë para lumit të dhimbshëm të burrave e grave të Kosovës që trokasin në derën tonë duke kërkuar ndihmë?...”

R.SH. – Vatikan

Më 18 tetor 1685 botohej “Çeta e profetëve” e imzot Pjetër Bogdanit

Më 18 tetor të vitit 1685 botohej “Çeta e profetëve” e imzot Pjetër Bogdanit, në Padova. Vepra teologjike e ipeshkvit shqiptar imzot Bogdanit cilësohet si libri i parë i prozës origjinale shqipe dhe mbetet një nga monumentet e gjuhës, kulturës dhe letrave shqipe.

Duke shfletuar kalendarin historik, kujtojmë 18 tetorin e vitit 1685, si datën e botimit të kryeveprës së ipeshkvit shqiptar imzot Pjetër Bogdanit “Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi” e njohur me titullin shqip “Çeta e Profetëve” shkruar në gjuhën shqipe dhe italiane.


Ja edhe titulli origjinal i plotë e veprës: “Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi, et eius evangelica veritate, italice, et epiroptice contexta, et in duas Partes divisa”. Kjo veprë teologjike e ipeshkvit shqiptar imzot Pjetër Bogdanit, shkruar për të ndihmuar besimtarët e krishterë shqiptarë në njohjen dhe thellimin e të vërtetave të fesë së krishterë, të të vërtetave ungjillore e në mënyrë të posaçme të figurës së Shëlbuesit të Botës, Jezu Krishtit, cilësohet edhe si libri i parë i prozës origjinale shqipe dhe mbetet një nga monumentet e teologjisë shqipe, të kulturës e posaçërisht të gjuhës e letrave shqipe.

Siç dihet, në saje të botimit të kësaj vepre “Çeta e Profetëve” në vitin 1685 në Padovë të Italisë, imzot Pjetër Bogdani zë një vend të dorës së parë në letërsinë shqipe të vjetër. Me botimin e parë, vepra zgjoi një interes të madh jo vetëm në trojet shqiptare po edhe në Itali e më gjerë, sikur dëshmojnë edhe dy botimet e kësaj vepre në vitet 1691 e 1702. Interesi i zgjuar nga kjo veprë është në radhë të parë teologjik,

sepse bënë fjalë për jetën e Jezu Krishtit, por edhe letrar e shkencor. Pranë të dhënave biblike, të vërtetave ungjillore, shtjellimeve teologjike, doktrinare e katekistike, në këtë veprë të imzot Pjetër Bogdanit gjenden edhe disa interpretime shkencore mbi dukuritë e natyrës, të bazuara në astronomi.

me anë të ditorisë e jetës, që buron nga Bariu i Mirë, Shëlbuesi i botës, Jezu Krishti. Ky është ideali që e frymëzoi imzot Pjetër Bogdanin gjatë veprimtarisë së tij në shërbim të Popullit e të Kishës, sikur dëshmon vepra “Çeta e Profetëve”.

Kjo veprë doli si një kërkesë e kohës



Rëndësia gjuhësore e kryeveprës së imzot Pjetër Bogdanit “Çeta e Profetëve”, është origjinaliteti, shkruar shqip e italisht, sepse botimi i fundit dhe më interesant, midis botimeve tjera të lashta në gjuhën shqipe, që kemi qysh, nga dom Gjon Buzukut me ‘Mesharin’, Lekë Matranga, Frang Bardhi, Pjetër Budi e tjerë. Veprat e këtyre autorëve ishin kryesisht përkthime të latinishtes e të italishtes me disa shtojca origjinale të vetë autorëve, ndërsa vepra e imzot Pjetër Bogdanit “Çeta e Profetëve” është krijimtari e tij teologjike, filozofike, historike e shkencore.

Në këtë veprë, shohim përgatitjen e lartë e të thellë teologjike e kulturore të imzot Pjetër Bogdanit, shohim vetëdijen që ai ka për situatën e rëndë në të cilën ndodhët populli dhe grigja e tij shqiptare nën zgjedhën otomane, dhe luftën që ai bën për ta “mposhtur errësirën e injorancës, për të ndriçuar njerëzit

që përjetonin trevat shqiptare dhe Evropë. Në vitin 1639 kryengritësit shqiptarë të Kelmendit kishin vënë në ikje një ushtri të madhe turke, ndërkohë që osmanët ishin kthyer përpara Vjenës vetëm dy vjet para daljes së veprës së imzot Pjetër Bogdanit. E pikërisht dëshira dhe urgjenca për të ungjillëzuar e riungjillëzuar shqiptarët, që kishin përqafuar fenë e pushtuesit turk, e shtynë imzot Pjetër Bogdanin që t’i kërkonte kolegjit të Propagandës së Fesë të Vatikanit botimin e një vepre ku të shpjegoheshin themelet e doktrinës së krishterë katolike.

Vepra e shkruar nën dritën e qirit në kushte të vështira, ku imzot Bogdani strehohej që mos ta kapnin turqit, nxirrej mbasi libra të tillë në gjuhën shqipe mungonin e botimet në gjuhën shqipe përndiqeshin e ndëshkoheshin, me shpresën se duke e ndriçuar kombin shqiptar, të tjerë Gjergj Kastrioti do të dilnin në mbrojtje të vlerave e të vet popullit.

Më 20 mars 1592 papas Lukë Matrënga përfundoi 'Doktrinën e krishterë'


Më 20 mars 1592 në Piana dei Greci (fshatin e Arbëreshëve) mbi Palermo të Sicilisë, prifti arbëresh, papas Lekë Matrënga e përfundoi 'E mbsuame e krështerë', 'Doktrinën e Krishterë', veprën e dytë të shqipes së shkruar, pas 'Mesharit' të dom Gjon Buzukut. 'E mbsuame e krështerë', që përmban doktrinën e krishterë, shkruar në dialektin toskë, është një Katekizëm prej njëzetetë faqesh, përkthim i veprës së jezuitit spanjoll, Atë Ledesma (1516-1575), shkruar latinisht.

Duke shfletuar kalendarin historik, më 20 mars kujtojmë veprën në dialektin toskë, të papas Lukë Matrënga 'E mbsuame e krështerë', 'Doktrinë e Krishterë' në dialektin toskë. Pra, më 20 mars 1592, në Piana dei Greci (fshatin e Arbëreshëve) mbi Palermo të Sicilisë, prifti arbëresh, papas Lekë Matrënga (150-1619) e përfundoi 'E mbsuame e krështerë', 'Doktrinën e Krishterë', veprën e dytë të shqipes së shkruar, pas 'Mesharit' të dom Gjon Buzukut. Vepra ka vetëm 28 faqe, e është me rëndësi historike e letrare, jo vetëm si botimi i dytë më i vjetër i letërsisë shqiptare, por edhe si vepër e parë e shkruar në toskërishte nga një arbëresh. Kjo veperkonsiderohet si dokumenti i parë filologjik i toskërishtes së shkruar dhe i dyti i shqipes, pas "Mesharit" të Gjon Buzukut.

Vepra 'E mbsuame e krështerë', që përmban doktrinën e krishterë, shkruar në dialektin toskë nga papas Lukë Matrënga, është pra një Katekizëm prej njëzetetë faqesh, përkthim i veprës së jezuitit spanjoll, Atë Dr.

Jakob Ledesma (1516-1575), shkruar latinisht.

Kopja e përkthimit shqip në dorëshkrim, ka ardhur deri në ditët tona në disa variante të ndryshme, i pari nga të cilët me sa duket me shkrimin e vetë Lukë Matrëngës, nxënës i Kolegjit Grek (Arbëreshë) në Romë, është kataloguar nën Codex Barberini Latini 3454 në Bibliotekën e Vatikanit. Një variant tjetër i botuar, është ai i shtypur në



Romë nga Guglielmo Facciotto 'me lejen e të parëve' më 1592, që u zbulua nga Mario Rok (Mario Roques). Nga një tjetër dorëshkrim është botuar një edicion i Doktrinës me shënime të Prof. M. La Piana në revistën 'Roma e l'Oriente' më 1912.

Po kujtojmë titullin e plotë i botimit: "Embsuame e chraesteræ. Baeæra per tae Vrtaenæ Atæ Ladesmæ sciochiaeriet Iesusit. E prierræ laetireiet mbae gluchæ tæ arbaeresciæ paer Lecæ Matraengnæ. Imbsuam i Cullegit

Graec tæ Romaesæ. Dottrina Christiana. Composta dal Reuerendo P. Dottor Ledesma della Compagnia di Giesù. Tradotta di lingua Italiana nell' Albanese per Luca Matranga alumno del Collegio Greco in Roma". (Doktrina e krishterë. Bërë nga i urti Atë Ledesma i Shoqatës së Jezusit. Përkthyer nga italishtja në gjuhën arbëreshe nga Lekë Matrënga, student i Kolegjit Grek të Romës.)

Vepra e meshtarit arbëresh papas Lukë Matrëngës përmban një hyrje në gjuhën italiane, një vjershë me tetë vargje që përbën llojin e parë të vargut të shkruar në shqip, si dhe katekizmin në formën e dialogut ndërmjet priftit e besimtarit që përgatitet për t'i marrë sakramentet e shenjta. Kjo veper u hartua për t'u përdorur nga arbëreshët që nuk e kuptonin variantin latinisht apo italisht të katekizmit të Kishës dhe u përdor nga qindra familje me prejardhje shqiptare në Kalabri, në Sicili e në Pulje të Italisë.

Ja edhe vjersha, titulluar 'Këngë e përshpirtshme' që konsiderohet si një nga vargënimet e para në gjuhën shqipe:

"Gjithëve u thëres, kush do ndëliesë,
Të mirë të krështe, bura e gra,
mbë fjalët të Tinëzot të shihi Meshë,
se s'ishtë njerii nesh që mkatë s'kaa;;
e lum kush e kujton se ka të vdesë,
e mentë bashkë mbë Tënëzonë i kaa,
se Krishti ndë parrajsit i bën pjesë,
e bën për bijr të tij e për vëlla"...
vargje që në shqipen e sotme tingëllojnë si thirrje aktuale drejtuar besimtarëve në këtë kohë të fortë Krezhmësh:
Të gjithëve ju thërres, kush do ndjesë,
Të krishterë të mirë, burra e gra,
me fjalë të Tënzot të shihni Meshë,
se s'është njeri prej nesh që mëkate s'ka.
E lum kush kujton se do të vdesë.
E mendtë bashkë në Tënzonë i ka,
se Krishti në parajsë atij i bën pjesë,
e bën për bir të tij e për vëlla".

Tashmë jam si engjëjt e humbur...

«Ai tha: Unë jam zëri i atij që bërtet në shkretëtirë: "rrafshoni udhën e Zotit!"».
(Gjoni 1, 23)

Nikolin Sh. Lëmezhi

Unë qeshë krijuar i bukur, magjepsja të gjithë, gëzoja zemrat në takimin me mua dhe vërtetë isha i dobishëm. Isha si një kuti e vogël, por shumë e lezetshme, transmetoja zërin e nënës tek i biri dhe zërin e të birit tek nëna larg.

Fillova si Engjëll drite, shkëlqejja shumë, gjithkush më donte, sepse nuk e dinin fundin tim, qeshë krijuar si Luçiferri: shumë i bukur e me vlera.

Atëherë, në fillim mbaja vendin tim, më përdornin thjesht për të komunikuar, për të dhënë një lajm apo një ftesë, për të bërë një urim apo bekim: isha realisht i dobishëm.

E pastaj më linin aty njerëzit, vazhdonin jetën e vet, jetonin. Unë nuk isha i kënaqur me atë, doja më shumë nga njerëzit. Fillova me lojëra për fëmijët e të rinjtë, gjithnjë pa ndryshuar shumë. Mbeta një kuti e vogël, si gjithmonë tërheqës, por doja më shumë.

Befas më erdhën ide të forta që t'iu vidhja kohën njerëzve, t'iu vidhja marrëdhëniet e t'i bëja sa më të vetmuar.

Asnjë nuk shihte se si hidhja rrënjë, si pushtoja jetën e tyre pak nga pak. Në pamje të jashtme po ndryshoja pak përmasën, ngjyrën, por strategjitë e mia ishin të fshehura: askush nuk mund t'i shihte.

Pas lojërave shpika infrarossi dhe Bluetooth, kaq u desh që të mbaja afër djem e vajza, për të kaluar orë të tëra duke kaluar këngë e mesazhe nga një kuti në tjetrën.

Doja që t'i bindja në masë njerëzit se unë mund të mbush boshllëqet e tyre, se unë do i bëja të lumtur, dhe kaq u desh: ia dola me ta.

Futa brenda kësaj kutie edhe fb, mesengjer e instagram, dhe bashkë me ta futa mendjet e zemrat e mbarë njerëzimit brenda meje, por unë jam thjesht një kuti e vogël. Brenda meje çdo njeri humbet kuptimin e orareve, humbet kuptimin e përgjegjësive, humbet miqësitë, dashuritë më të bukura, humbet vlerat. Dukem si një kuti, por jam shumë më shumë. Kam përdorur të gjitha taktikat që askush të mos e kuptojë se është i lidhur dhe i burgosur brenda meje.

Të gjithëve po ju merret fryma, por i kam bindur se është gjë e bukur. E që t'i mashtror më ëmbëlsisht kam bindur edhe të mirët që të më përdorin me të gjitha programet e mia.

Më përdorin politikanët, meshtarët e murgeshat, më përdorin ata që kanë famë për

shenjtëri dhe burrëri, më përdorin të varfërit... Më përdorin... Hahahahah, çfarë them unë?

Ata dikur më përdornin vetëm në fillim, kur isha si dritë, por tash i përdor unë ata.

Kam mbarë njerëzimin në dorën time: Duke rënë në duart e prindërve, iu hoqa atyre gëzimin e pastër për të shikuar në fytyrë fëmijët e tyre, duke rënë në duart e fëmijëve, iu hoqa atyre kënaqësinë për t'u gëzuar pak minuta me prindërit e tyre.

Unë jam një kuti e vogël, por nuk ngopem kurrë: kam nisur një rrugë pa kthim, është rruga e rënies. Iu mora të rinjve kohën e studimit, kohën e pushimit, kohën e punës.

Tashmë kjo është rruga ime, sajoj çdo ditë gjëra të reja që pas meje të humbasin shpirtat.

Ndonjë që ka si shpirt profetik ka filluar të kuptojë sadopak, por është si një zë që bërtet në shkretëtirë, askush pothuajse nuk dëgjon më. Është vonë.

Tashmë kam arritur kulmin! Kam forcë të divorcoj çiftet për një like të bërë në instagram. Më duhet shumë pak tashmë. Po bëj kërdinë, por sekreti im është se nuk e dinë. Njerëzit e çdo moshe shohin vetëm kutinë time diku më e vogël, diku më e madhe, por po bëj shumë.

Me arritjet e mia jam i kënaqur. Dikur njerëzit pinin ilaçe, kërkonin shërim që të bënin pak gjumë të qetë; tashmë është e kundërta: unë, kjo kuti kaq e vogël, zakonisht e zezë, por edhe me ngjyra nganjëherë, po bëj rrënimin. Iu kam hequr gjumin pothuajse të gjithëve, por e kam bërë shumë hollë këtë gjë, sepse kam hequr shijen për të bërë gjërat.

Kam hequr shijen për të bërë një gjumë të kthjellët, kam hequr shijen për të bërë një shëtitje të lirë në një lëndinë apo në breg të detit... Kam hequr shijen për të lexuar një libër me përralla, një roman apo një libër çfarëdo. Kam hequr shijen për të pirë një kafe me kënaqësi apo për të ngrënë një picë në shoqëri të të afërmeve dhe të shoqërisë. Nuk e dija që kam kaq forcë as vetë.

Sekreti më i madh është se njerëzit nuk e dinë atë që po bëj... ka ndodhur me mua pikërisht si me Engjëllin e Dritës. Nuk ngopem a kuptoni? Qëndroj në duart e babait, që është i dërrmuar nga puna, nga lodhjet e jetës dhe e mbaj peng aty pikërisht kur ka nevojë të flejë. Nuk dua që ndokush të jetë i qetë. I kam menduar gjërat mirë kur qeshë krijuar si kuti e vogël: kështu mund të më mbajnë edhe në tavolinë kur hanë bukë, kur dalin për kafe për t'u çlodhur, kur shkojnë në lutje.

Madje që të mos më vënë re, që të dukem krejt i mirë, iu dhashë mundësinë njerëzve të vendosin programe lutjeje. Po dua t'iu fus brenda kësaj kutie edhe meshtarët, edhe murgeshat edhe njerëzit më vullnetmirë. Por kështu është stili im: hy si i mirë që askush të mos e kuptojë. Kam strategji të pafund. Kanë mbetur

pak ata që janë të lirë por edhe ata janë pothuajse në duart e mia, mungon pak që t'ua marr frymën edhe atyre.

Nuk është se më intereson që t'iu fus këtu në këtë kuti, as t'iu marr frymën e t'iu lodh në çdo drejtim, por në fund është shpirti i tyre që më intereson.

Jam krejt si Engjëlli i Dritës, si Luçiferri. Në fillim sillja dritë, gëzim, krijoja bashkim dhe dashuri mes njerëzve, por shumë shpejt kuptova se mund të bëj kërdinë. Sekretin kryesor që më bën të kem gjithë këtë sukses është se askush nuk e din mirë sa kërdinë po e bëj.

Kam edhe një sekret tjetër: nuk i lë të shofin sa i keq jam bërë. I kam mashtruar me dritën fillestare. Oh sikur të shihnin sa i shëmtuar jam bërë. Në fakt isha shumë i bukur, qeshë krijuar i mirë, por nuk jam më ai që isha, jam krejt një tjetër. Por, askush nuk e di këtë gjë: i mashtror edhe duke shtuar gjëra të reja. Jam bërë mjeshtri më i madh i mashtrim-it i të gjitha kohëve: duhet shumë bekim që njerëzit ta kuptojnë. I kam mashtruar që në fillim.

Besoj se Shpirti Shenjt e parashikoi mirë kur bëri të shkruhej kjo fjalë në Bibël: "Plaga jote është e pashërueshme, varra jote është shumë e rëndë. Për plagë të tilla barna s'ka, varra jote s'do të bëjë vërragë" (Jeremia 30, 12-13).

Kam prapë shpikje të reja, sepse nuk dua të lë askënd të marrë frymë. Dua lirinë, zemrat, gëzimin, paqen, të mirat e të gjithëve pa përjashtim. Prandaj do të kem gjithmonë oferta të reja: për çdo festë fetare apo civile.

Arritjet e mia deri tani janë të jashtëzakonshme, por s'jam i kënaqur. Deri tani kam shkatërruar familje, kam krijuar përçarje, konflikte, kërcënime, frika të pafund, kam qenë përdorur që të nxis humbjen e thirrjes së një meshtari apo të një lëshkvi, kam shkatërruar biznese të bukura. Kur ndonjë fillon të kuptojë pak, unë jam krejt i përgatitur që t'ia shtrembëroj shikimin: kam menjëherë një ofertë të re, me të cilën e nxis të mendojë se po bëj mirë. Ofertat e mia nuk mbarojnë kurrë...

Njerëzit nuk e dinë, por po u ndalën sadopak do ta kuptonin sa kërdinë po e bëj në ta. Unë nuk ndalem kurrë, dhe prej meje nuk do të shpëtojnë kurrë, por ka një rrugë të vetme: që ata vetë të ndalen. E kanë të vështirë ta bëjnë se janë brenda meje, brenda asaj kutisë që shihet me sy. Të gjithë janë brenda, por nuk e dinë: ky është sekretin im. Edhe nëse ndalen, unë do të bëj të pamundurën që të paktën t'iu mbaj të burgosur aty brenda meje. Njerëzve ju kam fshehur edhe diçka: janë këtu brenda meje, por nuk i bëj të shohin sa i keq jam. Po të shihnin sa i shëmtuar jam bërë, do të vdisnin nga frika! Ata vetëm dinë se jam një kuti, herë më e vogël, herë më e madhe, herë me një program, herë me një tjetër: më njohin me emrin celular, por nuk e dinë se unë tashmë jam një engjëll i humbur, një engjëll i rënë dhe i çoj njerëzit në humbje!

Arrestimi, pushkatimi dhe lumnimi i Abati të fundit të Mirditës imzot Frano Gjinit

“Rrnoft Krishti Mbret! Rrnoft feja katolike dhe katolikët në botë! Rrnoft Papa! Gjaku dhe trupi jem mbeten këtu, por shpirti dhe zemra asht te Papa. Rrnoft Shqipnija!” – Këto kanë qenë fjalët e fundit të Abatis të fundit të Mirditës imzot Frano Gjinit, para togës së zezë të pushkatimit, më 11 mars të vitit 1948.

Klajd Kapinova

Tashmë lexuesit do të kenë në dorë një libër historik, me dokumente dhe arkiva origjinale: *“Martiri i kishës katolike Abati i Mirditës imzot Frano Gjini”* (Në 132-vjetorin e lindjes, 70-vjetorin e pushkatimit dhe 2-vjetorin e shenjtërimit).

Vepra voluminoze në fjalë, është shkruar mbas hulumtimeve shumë vjeçare në Arkivat Qendrore të Shtetit në Tiranë, nga bashkautorët studiues dhe publicistë: shqiptaro amerikani Tomë Mrijaj nga New York-u dhe Leonora Laçi nga Shkodra.

“...Në rastin e këtij vëllimit i shtohet profilit agiografik të Lumit imzot Frano Gjini edhe ai më shkencor, fryt i kërkimit të autorëve. Imzot Gjini është një figurë e spikatur e grupit të 38 të Lumëve të shpallur në vitin 2016, njeri i kulturuar, meshtar i zellshëm, bari i zhdërvjelltë i grigjës; hallkë e artë e zinxhirit që ka mbajtur të bashkuar Kishën Katolike në Shqipëri gjatë viteve të para të regjimit, i cili e shkatërroi me dhunë këtë kishë; pikërisht duke shpresuar që duke hequr qafe atë, i gjithë zinxhiri do të kishte humbur forcën e tij tërheqëse.

...Frika e çdo pushteti njerëzor është ajo e kundërshtarëve të tij; prandaj përballat me ta në të njëjtin nivel. Por në rastin e hierarkisë katolike të shkatërruar nga regjimi komunist është bërë gabimi i nënvlerësimit të atij “pushteti”, duke e barazuar me atë të cilësdo formë pushteti njerëzor: nuk e dinte diktatori që mbretëria e Krishtit “nuk është e kësaj bote”.

Dhe kështu, në përngjasim të Shenjtëve të Pafajshëm, imzot Gjini e gjen Martirizimin për Mbretërinë e Qiellit për përmbushjen e së cilës ka bashkëpunuar përgjatë kalimit të tij në këtë botë. Dhe tani jeton i lumë në lavdi...”, shkruan në hyrje të librit në fjalë Shkëlesia e Tij imzot Angelo Massafra O.F.M., Arqipeshkëv Metropolitan Shkodër-Pult.

Ky libër, është një përpjekje serioze për të sjellë para opinionit shqiptar për herë të parë të dhëna arkivore, familjare, dëshmi, faksimile, kujtime, dorëshkrime, letra,

procesverbale etj., duke pasqyruar për herë të parë në këtë libër ngjarje dhe episode historike, për personalitetin e lartë fetar, Abatin e fundit të Mirditës prelatin imzot Frano Gjinit dhe sekretarin e fundit të tij dhe Abacisë së Mirditës mons dr. Zef Oroshin (1912-1989), themeluesi i Lidhjes Katolike Shqiptaro Amerikane (15 Qershor 1962) dhe revistës kulturore Jeta Katolike (New York, 1966).

Në këtë mënyrë mons. dr. Oroshi si një mirditor i vendosur çoi në vend amanetin apo testamentin e eprorit të tij, prelatit dhe Abatis të Mirditës imzot Frano Gjini, i cili, ia kishte lënë porosi apo në besë këtij burri sypatrembur me tradita e zakone tipike shqiptare, kur e porositi që të hap kisha të reja për popullin apo emigrantët shqiptarë kudo që të jenë, duke dëshmuar se shqiptarët e kanë dashur dhe e duan shumë shembylltërinë e Krishtit të përvuajtur dhe të kryqzuar për ne...

Ky libër i pasur me dokumente dhe fakte historike, do të mbetet padyshim një vepër me vlera të pa kontestueshme, për historinë e dhimbshme por edhe krenare dhe të lavdishme të martirizimit të mons. Frano Gjinit, klerik katolik dhe komunitetit të përvuajtur të krishterë të saj.

Prelatët shembullorë dhe krenarë, trima dhe të pamposhtur përballë fortuneve komuniste të jetës prelatët Gjini-Oroshi, qysh në rini në vendlindjen e tyre kanë bashkëpunuar gjithnjë për famullitë e devotshme katolike të Mirditës, për të mirën e qendrës së saj të famshme historike Oroshin, dhe për të gjithë tokën e katedraleve apo kishën katolike brenda territorit të Abacisë së Mirditës.

Por regjimi i ri nuk mundi të durojë gjatë, nuk mundi të qëndronte pa gënjeshtat e veta e pa gënjeshtarë në gjithçka. Filloi shpejt persekutimi, një persekutim i posaçëm në botë e në historinë e kombit tonë, një masakër fanatike dhe e vazhdueshme pesëdhjetëvjeçare, për të rrenue gjithshka me vlerë që ishte arrijte sidomos mbas pavarësisë.

Lufia kundër Kishës e besimit katolik në këtë kohë mund të ndahet në tri faza:

E para, fillon nga vjeti 1945 deri në 1950. Asht ajo e zhdukjes së klerit me burgime e pushkatime, mbas torturave fort çnjerëzore, të zhdukjes së vlerave shpirtnore e kulturore katolike në mbarë Shqipërinë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, drejtues prej Enver Hoxhës, mbështetë në politikën sllave direkt në Shqipëri, drejtues prej Titos.

E dyta fazë, nisë nga vjeti 1951 deri në 1960 e asht ajo, që na po e quajmë një lloj pakësimi të ashpërsimit të luftës kundër fesë, mbas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë.

E treta, mbas prishjes me Bashkimin Sovjetik 1960, por tue mbajtë vijën staliniane, ajo e periudhës kineze, kur do të ngjajnë presione kineze, mbyllja e kishave dhe e të gjitha institucioneve fetare në Shqipëri, me revolucionin kultural, deri në 1990, - vlerëson ish drejtori i revistës popullore kulturore fetare shkodrane “Kumbona e së Dielës”, imzot Zef Simoni (1928-2009), Ipeshkëv Ndihmës në Arqipeshkvinë Metropolitanë Shkodër, Albania, në librin: “Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri, nga 1944-1990”.

Është shumë e vështirë në Shqipëri të gesh dokumente historike të kohës së diktaturës komuniste dhe në veçanti të klerit katolik, ku ato të mos jenë shkatërruar, manipuluar apo deformuar me paramendim nga origjinali i kohës kur ato janë kthyer në dokumente me ose pa vlerë historike.

Kjo për faktin, se regjimi komunist ka vepruar në mënyrë sistematike, për t'i manipuluar ato, duke futur dorë dhe rishkruar sipas dëshirës së tyre. Ajo që është interesante është se pjesa më e madhe e shkrimeve apo dëshmimeve janë dekonspiruar qysh në fillim, duke ia dhënë ato medias e cila si vegël qorre apo ndihmëse e regjimit të egër komunist i ka publikuar gënjeshttrat, me paramendimin se mund të poshtëroj figurat kryesore kundërkomuniste dhe klerin katolik. Të tilla janë shkrimet e turpit të botuara për shumë vite nga gazetatat qendrore dhe lokale, si: Zë(h)ri i Popullit, Bashkimi, Puna, Hosteni etj.

Sekretarët e partisë komuniste dhe gazetaret e tyre kanë shkruar artikuj denigrues me shpifje dhe trillime nga viti 1948-1952 në pothuajse çdo numër për të dy prelaët e pamposhtur kundërkomunist imzot Frano Gjinit dhe imzot dr. Zef Oroshin.

Ky fakt, tregon se klerikët tanë ndër shekuj kanë qenë të vendosur dhe në një mendje për besnikërinë e treguar gjithnjë ndaj Krishtit, si misionarë të vendosur të Tij, në çdo kohë dhe situatë, që u krijohet nga rrethanat dhe koha; besnik të palëkundur ndaj Selisë së Shenjtë në Vatikan dhe Atit të Shenjtë papës së Romës. Ato të bashkuar, po me këtë dashuri kanë dashur me gjithë zemër Atdheun e tyre të shtrenjtë, Shqipërinë dhe popullin e përvuajtur dhe masakruar shqiptar.

Bilanci historik është fatal për klerin katolik, por është edhe krenar njëkohsisht për kishën, klerin dhe popullin shqiptar, sepse sot kemi shumë shenjtë të kishës universale në botë. Kështu del se të gjithë klerikë katolikë shqiptarë gjatë diktaturës komuniste kanë kryer së bashku 881 vjet burg ose afro 9 shekuj, ndërkohë që të gjithë klerikët kishin kryer së bashku 450 vjet studime në 24 universitete të Evropës.

Nga të gjithë ata që diktatura gjeti gjallë, rezultoi se: janë pushkatuar mizorisht 29 klerikë (13%); janë mbytur ndër tortura 29 klerikë (13%); janë burgosur dhe internuar 93 klerikë (41%); kanë kaluar ndër kriza mendore deri në çmendri 6 klerikë (3%); janë detyruar të arratisën ose s'jane lejuar të kthehen në atdhe 35 klerikë (15%); janë përjashtuar nga shërbimi 19 klerikë (8%) dhe kanë vdekur në ankth e dhimbje pjesa e mbetur 15 klerikë (7%).

Kur komunizmi erdhi në Shqipëri përdori me efikasitet teknikat dhe praktikën e dhunës totalitare nga ish Bashkimi Sovjetik, si model origjinal të revolucionit socialist të tetorit të vitit të zi 1917.

Sikurse shihet edhe në librin arkivor, hartuar me shumë kujdes nga bashkautorët Tomë Mriaj dhe Leonora Laçi: *"Martiri i kishës katolike Abati i Mirditës imzot Frano Gjini"* (Në 132-vjetorin e lindjes, 70-vjetorin e pushkatimit dhe 2-vjetorin e shenjtërimit), del se vetë Hoxha ishte i bindur se feja i kishte rrënjë të thella, siç dëshmon një letër e shkruar vetë prej tij në vitin 1967, në të cilën i instruktoren sekretarët e parë në rrethe të jenë të kujdesshëm, por edhe të pamëshirshëm, sepse *feja ka ndikim të madh në popull*.

Ndër punët e para që bëri Qeveria komuniste me në krye kryeministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të PKSH, Enver Hoxha ishte se krahas organizimit nga organet e Policisë Sekrete ideologjike komuniste, shpalli një vendim urgjent, për paralizimin e institucionit të klerit katolik.

Këshilli Ministerial (6 mars 1946), *Vendim*: Të mbyllen të gjitha institutet shkollore të çdo natyre dhe të çdo grade të mbajtur dhe të drejtuar prej klerit katolik; Të mbyllen të dy seminarët, ai françeskan e ai jezuit; Shpërndarjen e organizatave e shoqërive të ndryshme, si dhe ndalimin e çdo veprimtarie të tyre; Rekuizimin e gjithë pronës së këtyre organizatave, institutëve dhe shoqërive qoftë të luajtshme ose të paluajtshme; Konfiskimin e gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhërit jezuit; Gjithë kjo pronë konsiderohet pronë shteti dhe marrja në dorëzim të bëhet menjëherë; Gjeneral Enver Hoxha (firma)

Në shkurt të vitit 1967, feja u ndalua zyrtarisht dhe Shqipëria u bë vendi i parë dhe i vetëm ateist i botës.

Fjalimi i mbajtur në Minierën e Memalias më 6 shkurt i 1967 nga diktatori

E. Hoxha mbi fenë solli ateizmin zyrtar në Shqipëri. Me dekret Nr. 4337, më 19 nëndor 1967: *"Mbi abrogimin e disa dekretëve"*, u shfuqizuan dekretet e viteve 1949-1951, që legalizuan kartat e komuniteteve fetare.

U ndaluan të gjitha ritet fetare e u vendos penalizime për shkelësit. Në vitin 1967, objektet fetare u shndërruan në teatro, palestra, punishte, vatra "kulture" dhe deri banjo publike.

Ndëshkimet e para të klerikëve fillojnë në vitin 1944, kur Hoxha ende nuk e kishte marrë pushtetin plotësisht. Ndëshkimi i diktatorit posaçërisht ndaj klerikëve katolikë i kapërcen caqet e përfytyrimit. Shumë u arrestuan dhe u ekzekutuan. I pari ndër ta dom Lazër Shantoja në kohë e sipër që komunistët qenë duke ardhur në fuqi. Ekzekutimi i Shantojës u bë me urdhër të drejtpërdrejtë të Enver Hoxhës, siç dëshmon ky kablogram i nënshkruar prej tij: *"Korpusit 3, Gjykatës Ushtarake Shkodër. Gjegje shkresës numër 5 datë 10 fruer 1945. Aprovohet ndëshkimi me vdekje i Don Lazër Shantojës dhe Sulçe Beg Bushatit. Stop. Na lajmëroni datën e ekzekutimit. Enver Hoxha"*. (Blendi Fevziu, Marrë nga libri "Enver Hoxha")

Kundërklerikalizmi dhe kundërkatolicizimi i regjimit të diktatorit Enver Hoxhës (nip hoxhe), ishin fryt ose rezultat i përplashes së rrymave ideologjike dhe traditave të ndryshme.

Nga ana e tjetër, si lëvizje elitash intelektuale, komunizmi i varfër në elitë intelektuale në Shqipëri kishte frikë vetëm rivalitetin dhe konkurrencën e fortë të unitetit dhe stoicizmin e kishës dhe katolicizmit shqiptar, mbasi lëvizje të tjera të mendimit elitar nuk kishte asokohe në vedin tonë.

Nga historia e shekujve të kaluar mësojmë, se katolicizmi si vlerë dhe kulturë e trashëguar brez mbas brezi brenda Atdheut tonë, kishte një traditë pozitive me prova dhe rezultate shumë të mira. Kisha dhe kleri katolik, për shekuj me radhë ishte dhe mbeti institucioni qëllimshëm më i organizuari dhe mbante të pashkëputura gjithnjë lidhjet e forta shpirtërore, kulturore më të rregullta me civilizimin dhe Perëndimin.

Kleri katolik kontributi e vet do t'a vazhdoj edhe në shembjen e komunizmit në Shqipëri dhe Kosovë, ku politika milosheviqiane kishte shuar autonominë e vendit (më 1989), të shoqëruar me persekutime ndaj shqiptarëve. Kjo dhunë mori fund me ndërhyrjen e NATO-s, mu aty ku kishte filluar kriza e Jugosllavisë.

Nga gjithë ajo që u tha më sipër, më plotë gojën mund të thuhet se askush nuk e ka ruajtur autoktoninë tonë ilire-arbërore-shqiptare më shumë se sa kleri ynë dhe krishterimi.

Dhe së këtejmi, nga ky krishterim i

lashtë e martir dolën edhe dy përfaqësuesit më të mëdhenj të shekullit XX: Patriku ekumenik gjithëortodoks, Atenagora I dhe shën Nëna Tereze.

"Kleri ynë... është duke i vazhduar me sukses arritjet mijëvjeçare të klerit katolikë në këto treva duke ndërtuar edhe Katedralen në Prishtinë kushtuar të Shenjtës Nëna Terëzë, Katedrale kjo që dita ditës është duke e rikthyer Kosovën në Europë, pjesë e së cilës ka qenë gjatë gjithë historisë së saj." (Dr. Jahja Drançolli, Kontributi i Klerit Katolik Shqiptar për "Fë e Atdhe" (Ligjëratë e mbajtur në Tribunën Shkencore Ditët e Shën Nënës Tereza, në Zagreb, 17 nëntor 2017).

Pas ripushtimit fatkeq të vendit, gjatë viteve 1944-1990 nga shqiptolësit fanatiku Hoxha dhe klika e tij kundërshtiptare edhe pse përdori sistematikisht hurin dhe litarin, nuk arriti të vendoste nën kontroll kishën katolike, meqenëse krerët e saj refuzuan të shkëputnin lidhjet me papën, Selinë e Shenjtë në Vatikan.

Komunizmi dhe arrestimi i abat Gjinit, trajton në gjerësi dosjen e plotë të gjyqit të mons. Frano Gjinit, letrat, që ai më pas i dërgon Gjyqit të Lartë Ushtarak në Shkodër në vitin 1948 apo letra që familjarët e tij i dërgojnë po kësaj Gjykate për faljen e tij, janë element që tregojnë se komunizmi ishte kthyer në një juntë ushtarake, që po hante shqiptarët për së gjalli. Gjyqet ndaj klerit katolik drejtohen dhe kontrollohen deri në fazën e ekzekutimit të tyre me radiograme direkte nga gjeneral Enver Hoxha.

Abat Gjini dhe mons. dr. Zef Oroshi, janë dy figura të mëdha të Mirditës, të cilët këto vitet e fundit falë studiuësve po ndriçohen mbi bazën e dokumenteve historike. Këto prelatë të kishës katolike shqiptare në vendlindje dhe diasporë, për fat të mirë po zbardhen shumë mirë në librin në fjalë, që tashmë kemi në dorë, të shkruar me gjuhën e fakteve dhe dokumenteve të reja nga bashkautorët Mriaj – Laçi.

Në ditët kur regjimi komunist po konsolidonte diktaturën e vet ushtarake, në abacinë e Mirditës, sikurse shkruan studiuesi Tomë Mriaj, një ndër miqët më të ngushtë të mons. Oroshit, zhvillohet një takim shumë i rëndësishëm në Abaci, në mes abatis të Mirditës mons. Frano Gjinit, mons. dr. Zef Oroshit dhe Kapidanit të Mirditës Llesh Gjonmarku që kishte ardhur nga forcat e rezistencës kundërkomuniste të maleve të Mirditës...

Ai iu drejtua abat Gjinit duke i thënë: *"Abat, unë kam ardh me ju thanë se situata këtu me këto bisha të egra komuniste, që nuk njohin as fe as atdhe, nuk asht e mirë dhe po druaj se mos po ju ndodh ndonji e papritur. Na me nacionalistët anti komunist të maleve, kemi munda që t'ju largojm shendosh e mirë jasht, deri sa t'a çlirojm vendin nga komunistët, na prap ju kthejmë në Abaci. Abat Gjini nuk iu përgjigj pyetjes së Kapidanit, por vetëm si shej falenderimi i buzëqeshi lehtë... Dhe Abati, me një*

qetësi karakteristike mu drejtue me këto fjalë: “Dom Zef, për Kapidanin edhe vdekja asht fitore. Ky ka vendos të luftoj deri në frymën e fundit. Zoti ju ndihmoftë këtyne trimave të lirisë, që po sakrifikojnë rininë e tyre. Unë prap i drejtohem Abat Gjinit, se Kapidan Llesh Gjonmarku e pat mirë që ju tha të largoheni nga Shqipëria, se komunizmi ka vendos me na vra të tanve. Por Abati i ynë, tha se nuk mendoj të largohem nga Shqipëria dhe që as më takon mue në ketë moshë si zot shtëpie të la Mirditën dhe grigjen vetëm në keto ditë të vështira për të gjithë ne... Ju duhet të largoheni dom Zef, se komunizmi e ka marrë të gjith vendin dhe po ban krime të përbindshme mbi popullin shqiptar dhe klerin katolik. Zoti i madh e din se sa ka me zgjat kjo mortaj komuniste në trojet tona. Ju duhet të largoheni për t'i dëshmuë botës krimet, që janë ba në tokën tonë martire. Detyra e juaj asht që një ditë të riktheheni në trojet e Arbërit, në Mirditën legjendare, ma të përgatitun, që t'i ndërtoni nga themelet rrënojat, që po ban çdo ditë komunizmi i zi. Ju duhet me ba presion politik në vendet dhe qeveritë perëndimore, ku ju do të jetoni që të rrëzohet komunizmi tek ne. Tregoni botës se shqiptarët nuk e duan këtë regjim gjakpirës bolshevik rus...”

Dhe mons. dr Zef Oroshi e plotësoi amanetin e lënë nga Abat mons. Frano Gjini, shumë dekada më parë në Mirditë, duke ndërtuar kishën e parë katolike shqiptare në SHBA, kishë e cila edhe sot mbas disa dekadave është shtëpia e ngrohtë e madhe atdhetare dhe fetare për të gjithë shqiptaro amerikanët. Ai, me fuqinë e Zotit, arriti të bëj realitet qëllimin fisnik të misionit të tij...

Mons. Oroshi, tha meshën e parë në natën e Krishtlindjes në vitin 1969, pranë Qendrës Katolike Shqiptaro Amerikane Zoja e Këshillit të Mirë, sot Zoja e Shkodrës, në Hartsdale New York, në prani të mijëra besimtarëve, pa dallim feje dhe krahine nga të gjithë trojet etnike shqiptare. Inagurimi zyrtar i Qendrës në fjalë u bë më 12 prill të vitit 1970. Kjo ngjarje e madhe historike (e përcjell me një shkrim special edhe nga gazeta e famshme amerikane The New York Times), shënon fillimin e historisë së jetës së famullisë të Kishës së Parë Katolike Shqiptare në SHBA.

Katolicizmi, në mënyrë të hapur u godit qysh në vitin 1944 barbarisht dhe pamëshirë si fe përparimtare dhe kulturë e mirëfilltë perëndimore, si parim dhe konkurrencë e fortë e atyre elitave, që regjimi komunist i shihte si kërcënim ndaj hegjemonisë mbisunduese, të cilën si kopje bolshevike dhe më vonë kineze kishte përpiluar të vendoste në vendin tonë.

Tek terrori kundërkatolik i viteve 1945-1948 komunistët e hoxhës së Gjykostrës u frymëzuan nga praktika e çmendur e luftës klerikale në Jugosllavi asokohe, të cilët në mënyrë të ngjashme po asgjësonin hapur elitat katolike kroate pro italiane etj.

Kësisoj agresiviteti që u tregua ndaj kishës katolike, besimtarëve të devotshëm të

saj dhe institucioneve të bashkëlidhura me të duhen parë si rrjedhojë e ateizmit fanatik të komunistëve.

Pas shumë vite pune të pandërprerë kërkimore shkencore, nga e gjithë kjo e dhënë rrënqethëse, Vatikanin, duke u bazuar nga faktet dhe dokumentet e shumta historike përzgjedhi mes tyre 38 klerikë, duke i shpallur martirë (më vonë shenjtër të kishës katolike), ku prej të cilëve 28 prej tyre nuk kanë fare varr. Nga këto klerikë të shpallur martirë të kishës katolike dhe më pas të shenjtë, një është gjerman, një polak dhe një italian.

Dëshmitë më rrënqethëse mund të mësohet shumë duke lexuar me shumë kujdes librin faktografik të bashkautorëve Mrijaj – Laçi, përkushtuar me shumë respekt dhe dashuri abatit të mirditës Frano Gjini. Ato janë në sinkronikë me dëshmitë dokumentare, shënime historike dhe dorëshkrimet e botuara nga disa klerikë të mbijetuar të sistemit komunist.

Kështu meshtari dom Lazer Shantoja, pasi hetuesi i preu këmbët me sopatë, e pushkatuan dhe e hodhën në një gropë pa emër; atë Serafin Koda, vdiq pasi hetuesi i futi thonjtë në fyt në kuptimin e vërtetë të fjalës; Maria Tuci, pasi refuzoi të bëhej e dashura e kryetarit të degës së Brendshme të Shkodrës, u torturua duke e futur në një thes të mbyllur bashkë me një mace dhe e qëllonin me shkop; papa Josif Papamihali, u torturua dhe u mbyt në baltën e kënetës së Malit; imzot Jul Bonati, u mbyll pa qenë i sëmurë në çmendinë e Durrësit dhe vdiq teksa mjekët bën me të eksperimente si një kavie; dom Aleksandër Sirdani, pasi u tërhoq zvarrë i lidhur pas një kali, u mbyt në një gropëfekalesh.

Dom Lazër Shantoja u pushkatua në prani të nënës së tij plakë, siç dëshmojnë disa prej pjesëtarëve të togës së pushkatimit, të dënuar edhe ata më vonë.

Aq shumë ishte torturuar truqi i tij, sa që e ëma, kur e pa në atë gjendje i kërkoi Mehmet Shehut që drejtonte hetimin e tij: “E paguej unë plumbin që ta pushkatoni tem bir. Nuk mund të shifet prej askuj në atë gjendje”. Sipas dëshmive, ajo që e qëlloi ishte një femër.

Edhe pse Dom Lazër Shantoja kish qenë i afërt me italianët, historia nuk mbaron këtu. At Bernardin Palaj vdiq në burg nga tetanozi që kish marrë prej telit me gjemba me të cilin i mbanin duart të lidhura ditë e natë.

Nga shqyrtimi i dokumenteve ajo që të bën përshtypje është qëndresa e pabesueshme e këtyre shërbëtorëve të Zotit.

Historia e Dom Shtjefen Kurtit preku rëndë Ronald Reganin. Me t'u bërë President i ShBA, ai iu referua së paku në dy raste asaj, si njëri prej historive më të trishita që kishte dëgjuar në jetë.” - (Blendi Fevziu, Marrë nga libri “Enver Hoxha”)

E megjithatë të gjithë klerikët katolik shprehën besnikërinë e palëkundur ndaj Jezu Krishtit, papës, Selisë së Shenjtë, në të

cilin besonin si atë Gjon Shllaku O.F.M., etj., që përpara se ta pushkatonin tha: “Rrroft Krishti Mbret! I falim armiqt tanë! Rrroft Shqipëria edhe pa ne!”

Poeti i ëmbëlsisë dom Ndre Zadeja, do të paralejmërorite rrezikun e komunizmit të zi, duke përoritur që të kenë kujdes rinia e famullisë dhe popullit të tij, ku ai shërbeu për shumë vite deri sa arrestohet: *Dy fjalë i kam sot me ju, sidomos me ju, o të rij. Një re e zezë me një ideologji të kuqe po vjen mbi kokat tuaja. Ajo ka ndërmend të shprazet mbi ju, por atëherë s'keni çfarë t'i bëni, veçse me mbajtë mbi shpinë dhe me duru të këqiat e tij.* (Klajd Kapinova, në librin: “Mes Kryqit e Atdeut”, Shkodër, 2002)

Kleri katolik shqiptar, të gjithë e dimë, ishte i pari e i vetmi në Shqipëri, që i dha dinjitet gjuhës së shkruar shqipe. Buzuku, Bardhi, Bogdani, Kazazi e të tjerë, janë dëshmuesit e pamohueshëm të kësaj veprimtarie kulturore-letrare, që zgjati plot dy shekuj.

“Kleri tjetër rregulltar paten lane vendin mbas të himit turqvet ndersa françeskanët ndëjen. Gjatë katër shekujve bartën me popullsin e vet besnik peshën e rande të salvimeve gati të pashkëputuma.” Dr. Gr. Uhlhorn, “Prej historis kishtare në Shqypni”, Revista “Hylli i Dritës”, 1940, 12. f.566

Por dimë edhe se me Kazazin kjo veprimtari ndërpritet. I dërmuar nga persekutimi, kleri shqiptar vijon të japë më shumë prova martirizimi, sesa shkrimi. Po fara e hedhur nuk humbet e flakëza e nderz ur nuk shuhet.

“...duke qenë lidhur me lëvizjen e rezistencës popullore të kohës, veprimtaria e autorëve katolikë të Shqipërisë së Veriut vuri bazat e letërsisë dhe të gjuhës letrare shqipe, duke bërë një hap të rëndësishëm përpara me përdorimin e gjuhës popullore – shqipen.” - Prof. Aleks Buda, në librin: “Shqiptarët dhe Trojet e tyre”, f.20, Botim i Akademisë Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1982.

Pse ne jemi krenarë sot për vlerat e trashëguara të krishtërimit tonë!? Përgjigja vjen e natyrshme dhe përgjigjen e jep vetë nëna histori.

Merita e madhe e krishtërimit ndër shqiptarë, është ndër të tjera tek ndihma e madhe që ka dhënë në lëmin e gjuhës shqipe, historisë, kulturës, artit, etj., zhvillimin e muzikës dhe tjera.

Shqiptarët katolikë mbetën pararoja e hyrjes shqiptare në Evropë...”, vlerëson Prof. Sami Repishti, ish i burgosuri politik (1946-1956) në Shqipëri dhe aktivist për të Drejtat e Njeriut në New York. (Prof. Sami Repishti, “Krishtërimi – pararojë e hyrjes shqiptare në Evropë”, Revista Jeta Katolike, New York)

Sëfundi, klerikët shqiptarë, si apostuj të vërtetë të fesë së Krishtit e të jetës së popullit, lindën, u formuan, jetuan e punuan në vende e institucione të ndryshme, me ideale e qëllime të shumta, prapsepër mbetën bijtë e popullit dhe tokës arbërore.



Pag ezime

Monika Berisha

Prind r: Prend & File Berisha
Kumbar : Nike M. & Prenda Berisha

Nikola Celic

Prind r: Steven & Melissa Celic
Kumbar : Arben Gashi & Natasja Curanovic

Vanessa Gjura

Prind r: Artur & Veronika Gjura
Kumbar : Robert & Rudina Gjonaj

Elena Grace Gjonaj

Prind r: Marjan & Xhuliana Gjonaj
Kumbar : Anton & Xhovana Gjoni

Kevin Turkaj

Prind r: Marash & Anna Turkaj
Kumbar: Arjan Shtogaj

Erik Nilaj

Prind r: Gjok & Eleanor S. Nilaj
Kumbar : Marsel Bitanji & Anila Kola

Leo Janovic Dillon

Prind r: Michael & Rosa Dillion
Kumbar : Nikolas Strada & Valentina Kinaj

Zana Dushaj

Prind r: Tom & Martha Dushaj
Kumbar : Mark & Age Dushaj

Abriela Lala

Prind r: Ernest & Silva Lala
Kumbar : Kristian & Rajmonda Lala

Silas Maximus Mehmeti

Prind r: Faik & Jennifer Mehmeti
Kumbar : Mark Kocaj & Jacklyn Gjelij

Laura Lulgjuraj

Prind r: Nuo & Milana Lulgjuraj
Kumbar : Nuo & Valbona Ljuljdjurovic

Noah Kalaj

Prind r: Frank & Fortesa Kalaj
Kumbar : Ilir Dedvukaj & Prena Gjokaj

Prek Vataj

Prind r: Santian & Miliana Vataj
Kumbar : Sonny & Violeta Vataj

Alek Cotaj

Prind r: Gjergj & Catherine Cotaj
Kumbar : Frank & Isabella Gjonaj

Joanna Kabashi

Prind r: John & Krsitiana Kabashi
Kumbar : Lek & Marte Rexha

Dianna Pashke Merditaj

Prind r: Pashk & Drita Merditaj
Kumbar : Pal & Antoneta Nikollaj

Zadora Ujka

Prind r: Evans & Klodiana Ujka
Kumbar : Adrian & Brisilda Daka

Nora Dushaj

Prind r: Kola & Angelina Dushaj
Kumbar : Nick & Tatiana Stanaj

Elena Lekocaj

Prind r: Julian & Violeta Lekocaj
Kumbar : Vilson & Valdete Gjonaj

Mila Victoria Nikaj

Prind r: Alexander & Diana Nikaj
Kumbar : Vladimir & Dijana Rukaj

Sofia Maria Nikaj

Prind r: Alexander & Diana Nikaj
Kumbar : Vladimir & Dijana Rukaj

Mark Gianni Zagreda

Prind r: Anton & Paola Zagreda
Kumbar : Giovanni & Alexa Zagreda

Sofia Cukaj

Prind r: Fredi & Anjeza Cukaj
Kumbar : Gasper & Violeta Cukaj

Nicholas Frank Selca

Prind r: Victor & Johanna Selca
Kumbar : Nosh Margilaj & Vitore Margilaj

Arianna Anna Prelidakaj

Prind r: Nok & Rafaela Prelidakaj
Kumbar : Lanndin & Elvira Hutaj

Mattias Cotaj

Prind r: Tish & Kristiana Cotaj
Kumbar : Daniel & Anita Tinaj

Briana Lisi

Prind r: Arben & Aurela Lisi
Kumbar : Markeljan Mesheqi & Rudina Simoni

Monica Ujkaj

Prind r: John & Vera Ujkaj
Kumbar : Mark & Liza Bojaj

Marie Nicolette Paljevic

Prind r: Ivo & Violeta Paljevic
Kumbar : Jak P. & Joanna Jankovic

Eliana Marie Gelevic

Prind r: Agron & Leonora Deda
Kumbar : Robert Micakaj & Violet Gelevic

Frank Jakaj

Prind r: Mark & Bergita Jakaj
Kumbar : Zef & Prena Shtyti

Priscilla Domino Nikci

Prind r: Joseph & Diana Nikci
Kumbar : Tom Nikci & Norma Zagreda

Franny Vataj

Prind r: Fran & Edmonda Vataj
Kumbar : John & Drita Simolacaj

Aurela Vukaj

Prind r: Agostin & Luljete Vukaj
Kumbar : Eduard & Jole Smajlaj

Aurelio Vukaj

Prind r: Agostin & Luljete Vukaj
Kumbar : Eduard & Jole Smajlaj

David Krcic

Prind r: Pasko & Katrena Krcic
Kumbar : Mark & Drita Dedvukaj

Noah Lindon Vukdedaj

Prind r: Ljindon & Viktorija Vukdedaj
Kumbar : Ivan & Nora Nikprelaj

Brian Lisi

Prind r: Kliton & Manjole Lisi
Kumbar : Arben & Antoneta Kodra

Michael Lisi

Prind r: Kliton & Manjole Lisi
Kumbar : Arben & Antoneta Kodra

Amy Rakaj

Prind r: Lulash & Rosa Rakaj
Kumbar : Luigj & Marije Ulaj

Luka Shtufaj

Prind r: Vilson & Marigona Shtufaj
Kumbar : Majkel & Margareta Lasku

Hera Rose Camaj

Prind r: Robert & Venera Camaj
Kumbar : Marko Saljanin & Rita G. Vaccaro

Nua Margilaj

Prind r: Nosh & Vitore Margilaj
Kumbar : Michael Selca & Drita Shkreli

Vander Margilaj

Prind r: Nosh & Vitore Margilaj
Kumbar : Victor & Johanna Selca

Drilona Marie Marke

Prind r: Feta & Merita Marke
Nunesha: Katrina Balaj

Gemma Aurora Mirukaj

Prind r: Dritan & Anita Mirukaj
Kumbar : Paulin & Miri Gjelij

Isabella Selmanaj

Prind r: Ejdhio & Xhuljeta Selmanaj
Kumbar : Ylli & Drilona Tinaj

Arijela Zefi

Prind r: Jake & Lisandra Zefi
Kumbar : Wilson Ramos Jr. & Xhulia Zefi

Meadow Rose Camaj

Prind r: Vincent & Gjovana Camaj
Kumbar : Jozo Kalinic & Gina Lombardo

Melinda Gjelij

Prind r: Ermond & Diana Gjelij
Kumbar : Kristjan Rudovic & Emily Vukaj

Giovanni Lushi

Prind r: Valmir & Oltide Lushi
Kumbar : Alfred & Anna Jaku

Antonella Jane Mirdita

Prind r: Ivo & Danielle Mirdita
Kumbar : Sandro & Marina Lula

Nika Mark Nuculovic

Prind r: Joseph & Arlinda Nuculovic
Kumbar : Patrick Rukaj & Jessica Nuculovic

Eva Prena Rudaj

Prind r: Robert & Olivia Rudaj
Kumbar : George Rudaj & Gina Lambard

Anna Tanushaj

Prind r: Bujar & Jehona Tanushaj
Kumbar : Roland & Dijana Tanushaj

Rafael Stefan Tanushaj

Prind r: Roland & Dijana Tanushaj
Kumbar : Bujar & Jehona Tanushaj

Anthony Ujka

Prind r: Marel & Anila Ujka
Kumbar : John & Drita Simolacaj

Lilyanna Kocovic

Prind r: Gjon Adriana Kocovic
Kumbar : Michael Cotaj & Lilyanna Kocovic

Ariana Jozefina Lekocaj

Prind r: Viktor & Lena Lekocaj
Kumbar : Luigji & Vilma Dedvukaj

Domenic Yash Nicaj

Prind r: Anton & Ashely Nicaj
Kumbar: Robert Nicaj

Julian Smajlaj

Prind r: Eduard & Jela Smajlaj
Kumbar : Lodovik & Zamira Volaj

Antonia Alia

Prind r: Leonard & Gjina Alia
Kumbar : Ardit Dekaj & Anica Marku

Jordan Therqaj

Prind r: Sander & Vera Therqaj
Kumbar : Mikael Therkiai

Kole Balbona

Prind r: Arben & Albana Balbona
Kumbar : Stiven & Sabina Juncaj

Lucy Rose Cacaj

Prind r: Simon & Jennifer Cacaj
Kumbar : Nikola & Lula Nikprelaj

Gebriel Thomas Pjetri

Prind r: Ernest & Maniola Pjetri
Kumbar : Leonard & Elvana Shkreli

Jason Peter Pjetri

Prind r: Ernest & Maniola Pjetri
Kumbar : Fran & Flora Elezi

Adelajda Pllumaj

Prind r: Arber & Besmira Pllumaj
Kumbar : Vilson Volaj & Ariola Zumaj

Mathew Lakaj

Prind r: Rudolf & Pashk Lakaj
Kumbar : Robert & Maria Nikprelaj

George Frank Lulgjuraj

Prind r: Frank & Diana Lulgjuraj
Nunesha: Katarina K. Taylor

Aria Selena Radoina

Prind r: Gilbert & Rita Radoina
Kumbar : Zef & Linda Vuksanaj

Gabriel Selmanaj

Prind r: Angjelin & Florinda Selmanaj
Kumbar : Simon & Suela Tinaj

Eliana Teresa Berishaj

Prind r: Nino & Age Berishaj
Kumbar : Kristo & Valerija Curanovic

Tristan Anthony Gjokaj

Prind r: Anthony & Kristina Gjokaj
Kumbar: Nicholas Gjokaj

Matteo Haxhari

Prind r: Rafael & Franceska Haxhari
Kumbar : Emiljan Haxhari & Enkeleda Nilaj

Kristiana Kola

Prind r: Fatjon & Antoneta Kola
Kumbar : Nush & Klodjana Sykaj

Christian Rukaj

Prind r: Anton & Josefina Rukaj
Kumbar : Ljeon & Suzana Ljuljdjiraj

Mathew Merdita

Prind r: Rikard & Greta Merdita
Kumbar : Ardian & Kristina Dodaj

Mark Niko Mreshaj

Prind r: Lek & Rajmonda Mreshaj
Kumbar : Pjerin & Blerta Lumaj

Paul Skrelja

Prind r: John & Olita Skrelja
Kumbar : Chris & Vera Skrelja

Amela Vuktilaj

Prind r: Fatmir & Klaudia Vuktilaj
Kumbar : Vinjoli & Ronalda Vacaj

Jake Anthony Vulaj

Prind r: Anthony & Kristina Vulaj
Kumbar : Martin Cacaj & Teuta Gjokaj

Matteo Qarri

Prind r: Anselm & Leonora Qarri
Kumbar : Pjerin & Fatbardha Firza

Leon Logan Rukaj

Prind r: Nick & Laura Rukaj
Kumbar : Frankie Rukaj & Shpresa Paljusevic

Ariana Rrukaj

Prind r: Gjoke & Shqipje Rrukaj
Kumbar : Emanuel & Edona Volaj

Jason Vukaj

Prind r: Agostin & Shpresa Vukaj
Kumbar : Ejlllo & Xhuljeta Selmanaj

Norah Juncaj

Prind r: Aleks & Ilirjana Juncaj
Kumbar : Leonard & Violeta Juncaj

Aleksander Markushi

Prind r: Ferdinand & Lindita Markushi
Kumbar : Alfred & Anna Jaku

Adrian Djonaj

Prind r: Doda & Violeta Djonaj
Kumbar : Gjon & Rosela Lucdjonaj

Jason Lumaj

Prind r: Mark & Rigene Lumaj
Kumbar: Engjell Lumaj

Jonathan Lucaj

Prind r: Davor & Valentina Lucaj
Kumbar : Zoran & Nicolette Curanovic

Davis Ulaj

Prind r: Leonard & Jolanda Ulaj
Kumbar : Sokol & Arta Beci

Deon Bujaj

Prind r: Anton & Mirjana Bujaj
Kumbar : Artan & Natalina Bujaj

Jason Pllumaj

Prind r: Marsel & Josephina Pllumaj
Kumbar : Bashkim & Dasantila Vushaj

Jonathan James Rrasi

Prind r: Filip & Magdalena Rrasi
Kumbar : Peter & Antigona Rrasi

Eduard Shkreli

Prind r: Valentin & Elizabeta Shkreli
Kumbar : Tom & Elizabeth Shkreli



Kurorëzime

Frank Dedvukaj me Daniella Lucaj
Më 22 shkurt 2020

Joseph Smajlaj me Eve Vucinaj
Më 6 qershor 2020

Fran Gjelosh Narkaj me Valentina Gjellaj
Më 21 qershor 2020

Veton Selimaj me Amanda Lulaj
Më 11 korrik 2020

Gjon Lugjuraj me Marina Juncaj
Më 11 korrik 2020

Anthony Ivezic me Ardijana Djellaj
Më 26 Korrik 2020

Anthony John Spinola me Christiana Gjellaj
Më 1 gusht 2020

Daniel James Hand me Victoria Popovich
Më 8 gusht 2020

Peter Perpepaj me Ariana Lynn Marano
Më 22 gusht 2020

Kristjan Gojani me Kaltrina Vokri
Më 28 gusht 2020

Antonjo Vuktilaj me Diana Kalaj
Më 5 shtator 2020

Krist Nikolla me Gloria Gjellaj
Më 3 shtator 2020

Nikoll Cotaj me Daniella Pepa
Më 19 shtator 2020

Elidon Shabi me Enkelejda Prenga
Më 20 shtator 2020

Pjerin Firza me Fatbardha Mitaj
Më 27 shtator 2020

Sandro Lula me Marina Ljuljovic
Më 10 tetor 2020

Kristofer Martinaj me Alexandra Brotz
Më 11 tetor 2020

Gregory David Romano me Linda Paljusevic
Më 16 tetor 2020

Evrin Mullalli me Leonora Camaj
Më 17 tetor 2020

Konti Markvukaj me Emi Cara
Më 18 tetor 2020

Latin Gjuraraj me Rogerta Nikaj
Më 18 tetor 2020

Klin Andereech Redoff me Donika Gazivoda Zadrime
Më 24 tetor 2020

Valon Shqutaj me Drita Nikac
Më 24 tetor 2020

Michael Cota me Nadezda Alekeyevina Khaynova
Më 7 nëntor 2020

Orland Gjuraraj me Irena Shulza
Më 14 nëntor 2020

Erluis Nacaj me Alaina M. Setzer
Më 21 nëntor 2020

Zhan Gjon Pellumbi me Enida Nacaj
Më 12 dhjetor 2020



Krezimime

Me 9 tetor 2020

Jack Toma	Jason Nikaj
Adriana Lulaj	Jason Shpijataj
Alexandra Grishaj	Kevin Preldakaj
Alfred Krasniqi	Klaudia Mrijaj
Amanda Ujka	Lenora Vuksanaj
Angjelina Gojani	Lorenc Balaj
Apollonia Lulgjuraj	Lujeta Culaj
Arian Berisha	Mariana Musaj
Christian Camaj	Maya Saljanin
Christopher Bucaj	Monika Popaj
Christopher Gjonmarkaj	Nadia Martinaj
Dajana Lucaj	Nikolet Vataj
Daniel Gjellashaj	Noah Cubi
Daniel Ndocaj	Paul Ujkaj
Donika Popaj	Peter Gazvioda
Eduard Zadrime	Peter Vuktilaj
Elizabeth Parubi	Silvio Ahmataj
Elton E. Coku	Suzana Smajlaj
George Gjergji	Teresa Gjergji
Gjergj Berisha	Valentina Vuksanaj
Isabella Pergjoni	



Kungimi i parë

Më 13 shtator 2020

Emma Camaj	Alexander Perlleshi
Stella Camaj	Frank Perlleshi
Joseph Curanovic	Gloria Perlleshi
Luca Dedvukaj	Valentina Preldakaj
Michael Gjokaj	Amy Rakaj
Evanxhelina Halilaj	Gabriel Rrasi
Julian Kaljevic	Mark Simonaj
Nicolas Kolaj	Mary Simonaj
Julianna Krasnic	Anthony Simoni
Bekim Jr. Lleshaj	Antonio Smajlaj
Nicholas Lleshaj	Regina Toma
Anthony Lulgjuraj	Isabella Tonaj
Mark Mirdita	Mark Ulaj
Lela Mriraj	Urci Jessica Vanessa
Josephine Mrizaj	Claudia Vukçaj
Mateo Mrizaj	Gabriella Vuksanaj
Mateo Palushi	Brandon Waters
Alexander Pergjoni	



In Memoriam

Albina Pervizi, 87-vjeç

Vdiq më 6 janar 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Dilj Ulaj, 88-vjeç

Vdiq më 12 janar 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Malësi, Tuz

Marko Rudovic, 88-vjeç

Vdiq më 16 janar 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Mark Lulgjuraj, 30-vjeç

Vdiq më 18 janar 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Mare Nikci, 90-vjeç

Vdiq më 26 janar 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Malësi, Tuz

Mria Shkreli, 85-vjeç

Vdiq më 28 janar 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nike Luka Shkreli, 94-vjeç

Vdiq më 6 shkurt 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nikola Pekic, 67-vjeç

Vdiq më 12 shkurt 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Ulqin

Gjeke Vuktilaj, 54-vjeç

Vdiq më 22 mars 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Shqipëri

Gasper Gjiododa, 61-vjeç

Vdiq më 24 mars 2020
U varros në "Greenwood Union Cemetery" Rye, NY.

Nike Gjeloshi Ulaj, 50-vjeç

Vdiq më 4 prill 2020
U varros në "St. Raymonds Cemetery", Bronx, NY.

Pjeter Smajlaj, 81-vjeç

Vdiq më 6 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Angje Shkreli, 82-vjeç

Vdiq më 7 prill 2020
U varros në "St. Raymonds Cemetery" në Bronx, NY.

Lush Gjon Mirakaj, 102-vjeç

Vdiq më 9 prill 2020
U varros në "Locust Valley Cemetery" Locust Valley, Y.

Vasel Rukaj, 60-vjeç

Vdiq më 11 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nreka Markic, 84-vjeç

Vdiq më 11 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Deda Markic, 69-vjeç

Vdiq më 12 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Lule Nikac, 87-vjeç

Vdiq më 12 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nue Kolaj, 71-vjeç

Vdiq më 13 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Luigj Vorfi, 72-vjeç

Vdiq më 14 prill 2020
U varros në varrezat "Hackensack Cemetery" Hackensack, New Jersey

Mark Jakaj, 51-vjeç

Vdiq më 15 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Shtjefen Nucullaj, 45-vjeç

Vdiq më 17 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nike Bujaj, 67-vjeç

Vdiq më 18 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Pashke Bekaj, 80-vjeç

Vdiq më 19 prill 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Shqipëri

Wilson Perlleshi, 46-vjeç

Vdiq më 20 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Ndue Pali Luli, 80-vjeç

Vdiq më 22 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Marko Dedivanovic, 81-vjeç

Vdiq më 25 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Steven Camaj, 38-vjeç

Vdiq më 26 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Vinko Camaj, 47-vjeç

Vdiq më 29 prill 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Djoka Gocjevic, 80-vjeç

Vdiq më 11 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Zef Marashi Ivezaj, 76-vjeç

Vdiq më 22 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

File Juncaj, 65-vjeç

Vdiq më 22 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjelosh Prella, 65-vjeç

Vdiq më 27 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Toma Krasnic, 59-vjeç

Vdiq më 27 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Fran Pllumaj, 56-vjeç

Vdiq më 30 maj 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjeka Nikprelevic, 87-vjeç

Vdiq më 21 qershor 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Malësi, Tuz

Leze Gjergj Celaj, 70-vjeç

Vdiq më 4 qershor 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Shqipëri

Vladimir Doda, 72-vjeç

Vdiq më 7 qershor 2020
U varros në varrezat "Woodlawn Cemetery", Bronx, NY.

Llazar Shtembari, 70-vjeç

Vdiq më 15 qershor 2020
U varros në "Rose Hills Memorial Park" Putnam Valley, NY.

Prenta Curanovic, 70-vjeç

Vdiq më 21 qershor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Petar N. Djonovic, 82-vjeç

Vdiq më 21 qershor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gonxhe Mhillaj Pepa, 81-vjeç

Vdiq më 29 qershor 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Shqipëri

Mark Gjelij, 62-vjeç

Vdiq më 3 korrik 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Kristina Catalic, 41-vjeç

Vdiq më 10 korrik 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nikola Catalic, 72-vjeç

Vdiq më 10 korrik 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Filip Uka Dedaj, 85-vjeç

Vdiq më 23 korrik 2020
U varros në varrezat "Queen of Peace Cemetery" në Stamford, Connecticut

Pashke Komani, 78-vjeç

Vdiq më 23 korrik 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Marko Perkovic, 62-vjeç

Vdiq më 30 korrik 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Mali Zi

Leka Gocaj, 81-vjeç

Vdiq më 4 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Victoria Gjelij, 60-vjeç

Vdiq më 9 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Peter Mark Krasniqi, 24-vjeç

Vdiq më 10 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjelosh Kol Drejaj, 78-vjeç

Vdiq më 13 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Zef Perndocaj, 80-vjeç

Vdiq më 24 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Zef Hila Kinaj, 84-vjeç

Vdiq më 30 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjergj N. Nikac, 74-vjeç

Vdiq më 30 gusht 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Nue Shala, 85-vjeç

Vdiq më 4 shtator 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Lisa Qafa, 58-vjeç

Vdiq më 6 shtator 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Zorka Bardhecaj, 91-vjeç

Vdiq më 18 shtator 2020
U varros në varrezat "St. Raymond's Cemetery" në Bronx, New York

Pashko Gashi, 72-vjeç

Vdiq më 19 shtator 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Luigj Kole Mundija, 62-vjeç

Vdiq më 26 shtator 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjon Nicaj, 92-vjeç

Vdiq më 1 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Jovan Tom Gjon Morinaj, 53-vjeç

Vdiq më 2 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Dusta Nikpreljevic, 84-vjeç

Vdiq më 5 tetor 2020
U varros në varrezat e vendlindjes, Malësi, Tuz

Marko Gjelij, 68-vjeç

Vdiq më 13 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Pal Gjeloshi Mujaj, 72-vjeç

Vdiq më 15 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Fran Zef Vukaj, 87-vjeç

Vdiq më 17 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Martin P. Grishaj, 54-vjeç

Vdiq më 21 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Mara Nikac, 93-vjeç

Vdiq më 26 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Isabella Gjinaj, 9-muaj

Vdiq më 29 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Lash Cotaj, 100-vjeç

Vdiq më 14 nëntor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjergj Luc Shqutaj, 86-vjeç

Vdiq më 18 nëntor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjon Bujaj, 78-vjeç

Vdiq më 29 tetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Gjergj Paloka Lulaj, 85-vjeç

Vdiq më 26 nëntor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Zef Koliqi Shkreli, 86-vjeç

Vdiq më 6 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Ivan Pali Curanovic, 79-vjeç

Vdiq më 7 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Prena Curanaj, 94-vjeç

Vdiq më 8 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Michael Anthony Nikic, 38-vjeç

Vdiq më 8 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Prenta Curanaj, 94-vjeç

Vdiq më 8 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Prenta Curanaj, 94-vjeç

Vdiq më 8 dhjetor 2020
U varros në varrezat "Raymond Hill Cemetery" në Carmel, New York

Dile Cekaj, 89-vjeç

Vdiq më 15 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Deto Perkovic, 91-vjeç

Vdiq më 21 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Vincent Mirdita, 63-vjeç

Vdiq më 20 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Bosilka Shala, 86-vjeç

Vdiq më 24 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Mrija Dushaj, 85-vjeç

Vdiq më 24 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Tom Ljulgjuraj, 44-vjeç

Vdiq më 25 dhjetor 2020
U varros në "Gate of Heaven Cemetery" Valhalla, NY.

Ukrime Krishtlindjen

dhe

Vitin e Re 2021



Familja e Noc Mati Gjonaj nga Reçi i Ulqinit dhe biri i saj i denjë
Mark Gjonaj, Anëtar i New York City Council